



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR

PËR

GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

Periudha e audituar
(01/01/2017 - 31/12/2020)

Tiranë, Janar 2022

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. HYRJE

III. METODA E AUDITIMIT

IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET SIPAS SISTEMEVE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKURIVE

Ky Raport Auditimi paraqet rezultatet e auditimit mbi vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme të projektuara dhe vendosura nga menaxhimi i gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të veprimtarisë.

Auditimi u krye në zbatim të nenit 10 dhe 14 të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. Të planit të punës të miratuar për vitin 2021, me nr.4763 prot. datë 30.09.2020 dhe programit të angazhimit të auditimit nr.07, ref. date 19.11.2021.

Objektivat e përcaktuara nga Grupi i Auditimit përfshijnë:

- Vlerësimin e përshtatshmërisë, efektivitetit dhe kohës së veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përfshirë veprimet korigjuese dhe parandaluese të ndërmarra në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në sistemet e : “Qeverisjes dhe administrimit”, “Menaxhimit të burimeve njerëzore”, “Pagat dhe shpërblimet”, “Të ardhurat nga tarifat gjyqësore”, “Prokurimet”, “Raportimit financiar dhe kontabilitetit”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën objekt auditimi ka funksionuar në bazë të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat është gjykatë me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, pjesë e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe njësi shpenzuese me buxhet më vete.

Për identifikimin e sistemeve të mësipërme, grupi i auditimit u bazua në raportet e mëparshme të auditimit, dispozitat e organizimit dhe funksionimit, strukturën organizative dhe dokumentacionin që disponon gjykata.

Oëllimi i auditimit: Verifikimi i nivelit të pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, informimi i menaxhimit mbi punën e bërë në gjykatë, raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve, dhënia e opinionëve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhënia e rekomandimeve për të ndihmuar gjykatën në përmirësimin e veprimtarisë së saj në arritjen e objektivave të veprimtarisë.

Periudha e auditimit: 01.01.2017 deri më 31.12.2020.

Përmbledhja e gjetjeve ,konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore: Gjetjet e trajtuar në raportin përfundimtarë janë sipas sistemeve/fushave të audituara, duke vlerësuar impaktin/ndikimin dhe rëndësinë e çdo gjetje është lënë dhe rekomandimi përkatës për përmirësim.

Në sistemin e qeverisjes dhe administrimit:

- Vazhdon të ngelet si problem, kushtet e sigurisë(garantimi i sigurisë në gjykatë), për shkak të pamjaftueshmërisë me ambiente për ushtrimin e veprimtarisë normale në gjykatë, mungesa e sallave të nevojshme për gjykim/ne raport me numrin e çështjeve për gjykim, të zyrave per administraten, ambienteve per arkive dhe magazinimin e materialeve te konsumit..etj.

- Hyrja e gjyqtareve, personelit administrativ të gjykatës, nga e njëjta hyrje ku futet publiku, te pandehurit, palet ndërgjyqese(perdoruesit e gjykates).

-Levizja e paleve ndergjyqese ne ambjentet qe nuk duhet te kene akses(ne koridoret ku jane zyrat e gjyqtareve dhe punonjesve te administrates).

- Mos instalim i pajisjes metal dedektor ne hyrjen kryesore te gjykates(per shkak te ambjentit/kushteve egzistuese, perdoren dedektor portable dore nga punonjesi i sigurise).

- Mos instalimi i sistemit elektronik me akses kontrolli me kartë elektronike, ne hyrjen/deren kryesore te gjykates, per monitorimin e hyrje daljeve te personelit dhe publikut.

Në sistemin e të ardhurave nga tarifat gjyqësore:

Në 514 dosje të kampionit te zgjedhur per auditim, në lidhje me aplikimin e tarifave gjyqësore, 23 prej tyre me objekt padie “zgjidhje martese”, janë trajtuar si “kërkesë” dhe tarifa gjyqësore është llogaritur dhe arkëtuar në vlerën 200 lekë (me pullë), duke mos arkëtuar vlerën 64.400 lekë. Tarifa e aplikuar në këto raste nuk është në përputhje me udhëzimin nr.33, datë 29.12.2014 shtojca nr.1 pika 8, gërma c (ku citohet tarifa për padi zgjidhje martese është 3000 lekë). Në këtë udhëzim nuk ka tarifë të përcaktuar për kërkesë zgjidhje martese.

Në sistemin e raportimi financiar dhe kontabilitetit:

Për pagesat e avokatëve të thirrur kryesisht në katër raste nuk është respektuar masa e shpërblimeve e përcaktuar në Urdhërin Nr.1284/3 datë 16.03.2005 të Ministrisë Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike”. Për të njëjtin përfaqësim në mbrojtje si; “seancë paraprake” në disa raste masa e pagesës të avokatit caktohet 2500 lekë në disa raste të tjera 3000 lekë dhe në disa raste të tjera 6000 lekë; “caktim masë sigurimi” në disa raste caktohet 2500 lekë në disa të tjerë 3000 lekë.

- Në sistemin e menaxhimit te burimeve njerzore; pagave dhe shperblimeve; prokurimeve me vlere te larte dhe vlere te ulet, sistemet e kontrollit kanë funksionuar mirë dhe janë efektive për arritjen e objektivave të veprimtarisë.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm: Nëpërmjet veprimeve konkrete gjykata ka zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimet: Jepen në Aneksin Nr.1 “Permbledhëse e Rekomandimeve”, të raportit përfundimtar.

Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e veprimtarisë gjyqësore, marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale; mbikqyrjen e administrimit te riskut dhe kontroleve; sigurimin dhe administrimin efektiv te punes organizative dhe përgjegjësiive. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale të gjykatës dhe i kanë dhënë menaxherit kryesor informacionin e duhur për menaxhimin me ekonomi, efektivitet dhe efijçencë të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

Gjykata ka marrë projektraportin e auditimit, të dërguar me shkresën përcjellëse Nr.5933 Prot. datë 31.12.2021 ka shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e dhëna, dhe një kopje të nënshkruar të projektraportit e ka kthyer në DAB me shkresën Nr.53 datë, 14 .01.2022. Gjykata nuk ka observacione në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga grupi i auditimit dhe i ka pranuar ato. Njëkohësisht gjykata informon për hapat e ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve duke e shoqëruar me akte të nxjerra në zbatim të tyre.

Nisur nga konstatimet të evidentuara në raportin përfundimtar, mjedisi i përgjithshëm i kontrollit vlërësohet me nivel të ulët risku.

Në vijim të raportit në pikën 4 “Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet” jepet informacion i detajuar i gjetjeve, rekomandimeve dhe opinionet e auditit për çdo sistem të audituar.

II. HYRJE

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat u realizua auditim i kombinuar që përfshiu : zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm; sistemin e qeverisjes dhe administrimit, menaxhimit të burimeve njerëzore, pagat dhe shpërblimet, të ardhurat nga tarifat gjyqësore, prokurimet, raportimi financiar dhe kontabilitetit.

Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore të mëposhme :

Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligjin Nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar me Ligjin Nr.8085, datë 13.03.1996 dhe Ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me UMF nr.8 datë 29.03.2012 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar, me UMF nr.7 datë 28.02.2018 dhe udhëzimet vjetore për zbatimin e buxhetit.

Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

VKM Nr. 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ligjin Nr.9975 datë 28.07.2008 “Per taksat kombetare”, udhëzimi Nr.13 datë 12.02.2009, i ndryshuar me udhezimin nr.991 date 02.03.2010 “Per percaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore”.

VKM përkatëse për pagat dhe shtesat mbi to, ndryshuar në vijimësi.

Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Udhezimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Urdhërin e KM nr.4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

Urdhërin Nr.1284/3 datë 16.03.2005 të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për masën e pagesës dhe faturës tatimore të lëshuar prej tyre.

Kuadri ligjor dhe rregullator mbi të cilin mbështete gjykata, vendimet, urdherat dhe udhezimet e KLGJ-së.

Për fillimin e angazhimit të auditimit, grupi i auditimit zhvilloi takimin fillestar në datën 17.11.2021 në gjykatë, me Zv.Kryetaren e Gjykatës, Kancelarin dhe K/D/Buxhetit. Në takim u prezantua qëllimi dhe tematika e auditimit, ku palët ranë dakort për fillimin e angazhimit të auditimit, sipas axhendës paraprake.

Angazhimi i auditimit u krye nga grupi i auditimit të përbërë nga:

- Z. Agim Koçi - auditues, njëkohësisht përgjegjës grupi
- Z. Aristotel Telhaj - auditues
- Zj. Marjana Sulshabanaj - audituese

Afati i Auditimit: 22.11.2021 deri më 10.12.2021.

Në datën 10.12.2021 grupi i auditimit zhvilloj takimin përmbyllës të auditimit, në prani të Zv/Kryetares të gjykatës, Kancelarit dhe Kryetares së Degës të Buxhetit, ku u trajtuan problematikat e rezultuara gjatë auditimit, si dhe dakortesia për rekomandimet që do të lihen për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në gjykatë.

Me shkresën Nr.5933 Prot. datë 31.12.2021 është dërguar në gjykatë Projekti i Raportit të Auditimit, një kopje e nënshkruar është kthyer në DAB me shkresën Nr.53 Prot. datë 14.01.2022.

Në datën 20.01.2022 nga grupi i auditimit u hartua Raporti përfundimtar i auditimit.

III. METODA E AUDITIMIT

Në angazhimin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika auditimi si: intervistimi, ekzaminimi, testimi, inspektimi fizik, leximi dhe studimi i raporteve, etj. Gjerësisht grupi i auditimit u fokusua në verifikimin e dokumentacionit dhe testeve në zbatim të "gjurmës së auditit".

Dokumentacioni i verifikuar u përzgjedh me kampion sipas vlerësimeve të kryera për fushat e audituara.

Vlerësimi i kampioneve të dokumentacionit ju nënshtrua përputhshmërisë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe llogaritjeve të kryera nga punonjësit përkatës.

Testimet u kryen për çdo sistem të audituar me marrjen e kampioneve. Kampionet u morën me teknikat e zgjedhjeve rastësore por dhe kohore dhe u shtrinë në të gjithë periudhën e auditimit.

Kontrolli me zgjedhje i Urdhër shpenzimeve dhe dokumentacionit shoqërues konstatoi se vlerat e paguara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në përputhje me Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2008 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Gjatë auditimit si teknika auditimi u perdoren: sondazhet, përzgjedhja në mënyrë rastësore, kombinuar me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (listë pagesat, përlllogaritjen e pagave, faturat, etj),

shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (për të gjitha sistemet e audituara sipas programit).

Nga grupi auditimit u plotësuan pyetësorët për mjedisin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të gjykatës, menaxhimin e burimeve njerzore, prokurimet, pagat dhe shperblimet, si dhe në fushën e llogarisë etj.

U vlerësua hartimi dhe zbatimi i plan veprimit mbi rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm. Grupi i auditimit gjykoj se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve.

IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM

4.1 Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Gjykata është audituar nga DAB në muajin Maj të vitit 2017. Në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar gjykatës janë lënë 13(trembëdhjetë) rekomandime nga të cilat:

- Rekomandime të pranuar plotësisht 13 (trembëdhjetë)

Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e lëna dhe ka ndërmarrë hapa konkrete duke miratuar planin e veprimit, caktuar personat përgjegjës dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve.

Plani i veprimit i miratuar është dërguar në DAB me shkresën nr.916/1 prot. datë 19.06.2017.

Nga verifikimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve bazuar në planin e veprimit të miratuar nga gjykata, akteve të nxjerra për zbatim dhe vlerësimit konkret të ecurisë së zbatimit të cdo rekomandimi, rezulton si vijon:

- Rekomandime të zbatuar plotësisht 13(trembëdhjetë)

Zbatimi i rekomandimeve ka ndikuar në përmirësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe uljen e nivelit të riskut.

Opinion i përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve: Nëpërmjet veprimeve konkrete gjykata ka zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi i menaxhimit për rekomandimet e lëna ndaj gjetjeve të auditimit të mëparshëm, ndikimi i tyre në përmirësimin e funksionimit të veprimitarës dhe arritjes së objektivave.

4.2 Sistemi i qeverisjes dhe administrimit

4.2.1 Organizimi i brendshëm, struktura, rregulloret, urdhërat, etj.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Berat ushtron veprimitarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ligjin Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligjin Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe ligjeve të tjera për administrimin publik.

Në mbështetje të legjislacionit përkatës, Gjykata kryen veprimitarine e saj procedurale dhe administrative, ku përfshihet: Pranimi, mbajtja dhe administrimi i akteve procedurale, provave materiale dhe shkresore të paraqitura, organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve, shpërndarja e çështjeve për gjykim sipas shortit, njoftimet dhe komunikimet e akteve procedurale, përgatitja dhe

shpallja e listës së gjykimeve, mbajtja e procesverbaleve të seancës gjyqësore, si dhe respektimi i kërkesave të solemnitetit në gjykim, etj.

Për periudhën objekt auditimi gjykata ka funksionuar bazuar në strukturën organizative të miratuar nga Ministri i Drejtësisë me urdhër nr.1978, date 16.03.2016, me 29 punonjës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 115, date 05.03.2020, ka miratuar shtesë në organikë me 2(dy) punonjës, konkretisht: 1(një) sekretarë gjyqësor dhe 1(një) nëpunës gjyqësor, nga 29 punonjës është rritur në 31 punonjës.

KLJG me shkresën nr.1763 prot,datë 21.03.2019, "Miratim punonjësi me kontratë te perkoheshme pune per vitin 2019", ka miratuar tre punonjës me kontratë me kohe te pjesshme, 4 ore/dite, vjetore, per 1(nje) sekretare gjyqesore, 1(nje) nepunes gjyqesor dhe 1(nje) arkivist.

KLJG me shkresën nr.66 prot,datë 06.02.2018, "Miratim punonjësi me kontratë te perkoheshme pune per vitin 2018", ka miratuar tre punonjës me kontratë me kohe te pjesshme, 4 ore/dite, vjetore, per 1(nje) sekretare gjyqesore, 1(nje) nepunes gjyqesor dhe 1(nje) arkivist.

Nga krahasimi i numrit të punonjësve sipas strukturës të miratuar me numrin e punonjësve në fakt, ne fund te muajit dhjetor 2020, rezulton se numri i punonjësve ne fakt (27) është më i vogël se numri i punonjësve në organikë (31), me pak 4 punonjes, konkretisht:

- KPA me vendimin nr.17, date 15.07.2020 ka shkarkuar nga detyra Kryetarin e Gjykatës, vend i cili aktualisht eshte vakand dhe mbulohet nga zv/Kryetarja e gjykates.
- Me vendimin e KLJG-se nr.204, date 11.06.2020, 1(nje) gjyqtare eshte transferuar perkohesisht, per nje vit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kavaje.
- Ne datën 21.10.2019, 1(nje) gjyqtare eshte komanduar per dy vjet ne KLJG.
- Ne datën 31.01.2020 nje sekretare gjyqesore eshte larguar me deshiren e saj dhe eshte krijuar vendi vakand.
- Nje sekretare regjistruese eshte shtuar ne organike në vitin 2020.

Organika e gjykatës gjatë periudhës objekt auditimi **është respektuar në përputhje me miratimet e bëra.** Pozicioni i arkës dhe i magazines për periudhën objekt auditimi është mbuluar nga arkivistia e gjykatës. Delegimi i detyrave dhe përgjegjësive është bërë sipas Ligjit 10296 "Per menaxhimin financiare dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Kodin e Procedures Administrative.

Në mungesë të Rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, në nevojë të gjykatës, është hartuar rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat", miratuar me urdhërin e kryetarit të gjykatës nr.prot. 37 datë 22.02.2018.

Rregullorja është hartuar bazuar në Ligjin Nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika (dh) "Kompetencat e Kryetarit të Gjykatës", "....kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtarinë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj".

Referuar nenit 1 të rregullores *Objekti i kësaj rregullore është*; bashkëndimi në një akt të vetëm , si dhe përditësimi i të gjitha rregullimeve të urdhëruara nga titullari i gjykatës në bazë dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nën ligjore në fushën e sistemit gjyqësor, për të standartizuar dhe unifikuar tërësinë e veprimtarisë së administrimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Kjo rregullore është në fuqi dhe është e zbatueshme, deri në hartimin dhe miratimin e Rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave nga KLJG (me miratimin e përshkrimeve

standarde të punës të punonjësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës) në përputhje me nenin 94 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Me urdherin e kryetarit të gjykatës nr.37/1, prot.date 22.02.2018, është miratuar rregullorja “Për perdorimin dhe mirembajtjen e pajisjeve të teknologjise se informacionit”.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të ligjit 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur dhe ka funksionuar Këshilli i Gjykatës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur në lidhje me mbledhjet e kryera gjatë periudhës objekt auditimi, rezulton se: Te gjitha mbledhjet e Keshillit të Gjykatës janë regjistruara dhe dokumentuar me procesverbal dhe mbahen në dosje të veçanta.

4.2.2 Planifikimi strategjik, objektivat, planet vjetore dhe operationale.

Në analizat vjetore të punës, gjykata ka përcaktuar objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm, për periudhën në vijim. Për periudhën objekt auditimi, është hartuar dhe miratuar, deklarata e misionit, plani vjetore i punës dhe plani i veprimit për përmirësimin e sistemit të MFK, si dhe regjistri i riskut.

Me urdhër të veçante të Kryetarit të gjykatës është ngritur grupi i punës, që ka vlerësuar kërkesat e çdo sektori, shpenzimet për paga dhe shtesa, sigurime shoqërore dhe materiale të ndryshme për funksionimin e punës në vijimësi të gjykatës, kërkesat për shpenzime operative dhe investime, duke argumentuar çdo zë të kërkuar. Hartimi i projektbuxhetit është bazuar në kërkesat e domosdoshme për funksionimin normal të gjykatës, si dhe në deklaratën ekzistuese të politikës së programit, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Raporti i PBA të hartuar nga grupi i punës të ngritura për këtë qëllim, është vlerësuar dhe miratuar nga Këshilli i Gjykatës.

4.2.3 Menaxhimi i riskut

Në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, u krye auditim mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjykata, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ka hartuar dhe derguar brenda afateve ligjore në organin qendror pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën objekt auditimi (shkresa nr.85, date 20.01.2020 dhe nr.181, date 05.02.2021).

Nga grupi auditimit u vlerësuan pesë komponentët e sistemit të MFK: mjedisi i kontrollit, vlerësimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi.

a) Mjedisi i kontrollit

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II-të, neni 8, pika 8(b), i ndryshuar. Me urdherin nr.9, date 08.01.2020, ndryshuar me urdherin nr.6, date 06.01.2021 është ngritur *Grupi i Menaxhimit Strategjik (G.M.S)* në përbërje të të cilit është zv/Kryetari i Gjykatës në rolin e Nëpunësit autorizues, Kancelari në rolin e Menaxherit dhe K/D/Buxhetit në rolin e Nëpunësit zbatues.

Çështjet kryesore dhe problemet që kanë dalë brenda njësisë i janë parashtruar GMS, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave përkatëse, në përputhje me nenin 27, pika 1 të ligjit për MFK-në. Nga auditimi rezulton se GMS ka organizuar takime herë pas here për të diskutuar problemet, sipas përcaktimeve në urdhërin e ngritjes të GMS. Në lidhje me identifikimin e objektivave, risqeve, analiza, vlerësimi dhe menaxhimi i tyre.... etj.

Dokumentimi i çështjeve të trajtuara dhe zgjidhjet e dhëna, janë evidentuar rregullisht në procesverbalet e çdo mbledhje.

b) Menaxhimi i riskut

Risiet të identifikuara janë marrë parasysh në hartimin e objektivave afatmesëm, brënda kapaciteteve dhe mundësive të gjykatës. Risiet e identifikuara dhe çështjet që kanë të bëjnë me risiet në arritjen e objektivave, janë trajtuar në mbledhjet javore të organizuara nga zv/Kryetari i Gjykatës. Rezultatet dhe konkluzionet e mbledhjeve, i'jan komunikuar stafit për të ndërgjegjësuar praninë e risieve.

Në lidhje me menaxhimin e riskut, për periudhën nën auditim është hartuar regjistri i riskut, në përputhje me kërkesat e nenit 11, pika 2 dhe nenit 12, pika 3(d) të ligjit "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili është dërguar brenda afateve ligjore në formë elektronike dhe shkresore në organin qendror.

Në regjistrin e riskut janë evidentuar risiet e mundshme që mund të ndodhin, si: pamjaftueshmeria me ambiente për arkivimin e dosjeve gjyqesore(mbingarkes ne zyren e arkives), munges zyre për punonjesit e administrates, pamjaftushmeri me salla për zhvillimin e seancave gjyqesore dhe ambienteve të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve gjyqesore, siguria në ambientet e brendshme dhe të jashtme të gjykatës, rritja e volumit të çështjeve gjyqesore, që ka sjell kosto me të lartë për njësi produkti/me shumë shpenzime se sa plani ...etj.

Për rastet/risiet të evidentuara në regjistrin e riskut, janë marrë masat e nevojshme për minimizimin/menaxhimin e tyre, ka ende nevojë për një kuptim më të plotë dhe trajnime specifike në fushën e menaxhimit të riskut.

c) Aktivitetet e kontrollit

Një kontroll i rëndësishëm mbi aktivitetin e gjykatës, është ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësiive të personelit.

Në Rregulloren e Brendshme janë të përfshira detyrat që kryen secili punonjë/pershkrimet e punës. Struktura mbi të cilën funksionon institucioni, lë pak vend për mospërfshirjen e një punonjësi në më shumë se një detyrë njëkohësisht(k/d/b regjistron dhe kontrollon trasaksionet financiare; arkivistia kryen detyren e arkëtarit dhe magazinierit; përfshirja e punonjesve në komisionet për prokurimin e fondeve publike etj).

Në gjykatë, rendesi i është kushtuar kontrolleve parandaluese dhe zbuluese, kryesisht kanë të bëjnë me kushtet e sigurisë në gjykatë, për shkak të funksionit dhe kushteve që ka gjykata aktualisht (trajtuar me poshte).

d) Informacioni dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit të dobishëm midis punonjësve në të gjitha nivelet, si në mënyrë vertikale dhe horizontale, dhe midis sektorëve për të mbështetur vendimet dhe koordinimin e aktiviteteve. Informacioni është komunikuar menaxherëve dhe punonjësve të tjerë që kanë nevojë për to në një formë dhe brenda një afati kohor që i ka ndihmuar ato në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive.

Për çështjet gjyqësore informacioni merret nëpërmjet sistemit ICMIS, i cili gjeneron informacion mbi çështjet që nga momenti regjistrimit deri në dhënjen e vendimit të gjykimit, si dhe sistemin Audio Recorder për regjistrimin e seancave, sistemi back up kryhet në mënyrë automatike, si dhe manualisht nga specialisti IT-së.

Informacionit financiar, regjistrohet në programin financiar “Alpha Web”. Sistemimi dhe hedhja e të gjithë informacionit financiar ka krijuar mundësinë për gjenerimin në çdo moment të raporteve të ndryshme përmbledhëse për financën, buxhetin, shpenzimet, personelin, inventarizimin etj., duke dhënë një informacion të plotë i cili ka krijuar mundësinë e gjykimit mbi realizimin apo progresin e objektivave të njësisë.

Të gjithë punonjësit kanë emaile zyrtare për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm.

Gjithashtu gjykata disponon Website e saj ku merret informacioni përkatës nga publiku.

Lidhur me komunikimin në nivel horizontal dhe vertikal brenda institucionit nuk ka një rregullore të shkruar por kryesisht komunikimi kryhet nëpërmjet email-it zyrtar, komunikimit verbal, urdhërave të dala për çështje të veçanta.

e) Monitorimi

Në gjykatë, monitorimi kryhet nëpërmjet raportimeve periodike të menaxherëve (Kancelarit, K/D/Buxhetit dhe K/Sekretares) tek zv/Kryetari i Gjykatës. Nëpërmjet raportimeve periodike 4-mujore që gjykata raporton në organin qendror dhe analizave të kryera për fusha të veçanta të veprimtarisë së sektorëve të gjykatës. Në përputhje me afatet ligjore dhe nënligjore në fuqi monitorimi është kryer dhe nga DAB-ja,. Për herë të fundit ky monitorim/auditim në këtë institucion është kryer në muajin prill të vitit 2017(*trajtuar në pjesën e zbatimit të rekomandimeve të lëna*).

4.2.4 Siguria fizike

Nga inspektimi fizik që grupi i auditimit kreu në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të gjykatës me prezencën e Kancelarit, u konstatuan probleme që kanë të bëjnë me krijimin e një ambjenti të përshtatshëm pune për punonjësit dhe publikut, për t’ju ofruar shërbime gjyqësore në cilësi të kërkuar, problem që kanë të bëjnë me kushtet e sigurisë, për garantimin e sigurisë në gjykatë.

Në katin e parë të godinës së gjykatës funksionon sporteli i shërbimit, ku ofrohet çdo lloj informacioni në lidhje me gjykimet, dhënien e kopjeve të vendimeve, depozitimin e kërkesave, kërkesë padive, ankimeve dhe rekurseve, dhënien e vërtetimeve, dhënien e kopjeve të akteve të ndryshme, depozitimin e kërkesave për shtyrje, si dhe çdo dokumentacion tjetër. Të gjitha shërbimet për publikun kryhen nga zyra e k/sekretarise, nëpërmjet sportelit të shërbimit, nën mbikqyrjen e kancelarit të gjykatës i cili përgjigjet për funksionimin e tij, duke raportuar çdo lloje problemi tek Kryetari i Gjykatës.

Palët dhe publiku në lidhje me gjykimet, oraret e gjykimeve, gjyqtarët, objektin e gjykimit, palët ndërgjyqëse, numrin e sallës e shikojne në **monitorin** e vendosur ne hollin e gjykates. Ne hyrje te deres kryesore te gjykates eshte vendosur **kendi i afishimeve** i cili perditesohet cdo dite pune. Gjykata ka **Website** e saj ku meret informacioni perkates nga publiku, si dhe **kutia e ankesave** me qellim depozitimi i ankesave te qytetareve.

Gjetje nga auditimi Nr.1: Hyrja e gjyqtareve, personelit administrativ të gjykatës, behet nga e njehta hyrje ku futet publiku, te pandehurit, palet ndergjyqese(perdoruesit e gjykates).

-Levizja e paleve ndergjyqese ne ambjentet qe nuk duhet te kene akses(ne koridoret ku jane zyrat e gjyqtareve dhe punonjesve te administrates).

- Mos instalim i pajisjes metal dedektor ne hyrjen kryesore te gjykates(per shkak te ambjentit/kushteve egzistuese, perdoren dedektor portable dore nga punonjesi i sigurise).

- Mos instalimi i sistemit elektronik me akses kontrolli me kartë elektronike, ne hyrjen/deren kryesore te gjykates, per monitorimin e hyrje daljeve te personelit dhe publikut.

- Mungesa e ambjenteve te nevojshme: zyra per punonjesit e administrates, salla per zhvillimin e seancave gjyqesore, per arkivimin e dosjeve gjyqesore, per studimin e dosjeve gjyqesore nga avokatet kryesisht apo per psikologet.

Rekomandimi Nr.1: Për garantimin e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë. Të shikohet mundësia për mbylljen me vetrat/material duroalumin/plastik+xham, hyrjeve të koridoreve të katit të parë dhe të dytë të godines, për të mos lejuar hyrjen e personave që nuk kanë akses hyrje në ambjentet ku janë vendosur zyrat e gjyqtareve dhe punonjesve të administrates. Në hyrjen kryesore të instalohet sistemi elektronik me akses kontrolli me kartë që mundeson hyrjen e personave që kanë akses hyrje dhe për monitorimin e hyrje-daljeve të personelit.

Opinionimi i përgjithshëm për sistemin e qeverisjes dhe administrimit: Sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar mire dhe janë efektiv.

4.3 Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore përbën një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

4.3.1 Mbi procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjesve.

Për periudhën objekt auditimi, për vendet vakante të krijuara në gjykatë nga shtesa në organike 2(dy), largime nga puna me kerkese/deshire të punonjesve 4(kater) dhe dalje në pension pleqërie 5(pese), gjithsej janë bërë 11(njëmbëdhjetë) pranime/rekrutime në punë, konkretisht:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 115, datë 05.03.2020, ka miratuar shtesë në organikë me 2(dy) punonjës: 1(një) sekretarë gjyqësorë dhe 1(një) nëpunës gjyqësor.

Kane dale në pension pleqërie 5(pese) punonjes, konkretisht, në vitin 2018, 1(nje) nepunes gjyqesor/ftus, në vitin 2019, 2(dy) sekretare gjyqesore, në vitin 2020, 1(nje) sekretare gjyqesore dhe 1(nje) punonjes sigurie.

Jane larguar me deshire 4(kater) punonjes, konkretisht: Në vitin 2017, 1(nje) sekretare gjyqesore, në vitin 2018, 1(nje) sekretare gjyqesore, në vitin 2020, 1(nje) specialist IT dhe 1(nje) sekretare gjyqesore.

Me zgjedhje u verifikuan 4(kater) dosje, në lidhje me rregullshmerine e pranimet në punë, konkretisht: Dosja që i perket sekretareve gjyqesore, Elira Mustafallari dhe Adelajda Olldashi, emeruar perkatesisht me Urdherat Nr.110, datë 31.12.2019 dhe Nr.112, datë 31.07.2017. Dosja që i perket

punonjesit te sigurise Viktor Zeqo, emeruar me Urdherin Nr.85, date 03.11.2020. Dosja qe i perket nepuneses gjyqesore Nevila Xhako, emeruar me vendimin nr.86, date 03.11.2020.

Rekrutimi/pranimi i punonjesve te gjykates eshte bere sipas Kodit te Punes, kurse rekrutimi/pranimi i punonjesve te tjere te administrates eshte bere sipas Ligjit Nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit te Keshillit te Larte Gjyqesor Nr.622, date 10.12.2020 "Per levizjen paralele, ngritjen ne detyre dhe pranimin ne sherbimin civil gjyqesor".

Ne zbatim te nenit 50, 84-88 te Ligjit 98/2016, date 06.10.2016 "Per organizimin e pushtetit gjyqesor ne Republiken e Shqiperise", Vendimit te Keshillit te Larte Gjyqesor nr.338, date 24.09.2020, "Per percaktimin e kriterave dhe procedurave per dhenjen e statusit te nepunesit civil gjyqesor, punonjesve ne detyre ne gjykate", Keshilli i Gjykates ka kryer verifikimin e plotesimit te kriterave formale per te gjithë punonjesit ne detyre, subjekte te nenit 50, pika 1 te ligjit nr.98/2016.

Per te gjithë kategorite e punonjesve te parashikuar ne Ligj dhe ne Vendimin e KLGJ-se qe kane plotesuar kriteret e pergjitheshme dhe te vecanta, Keshilli i Gjykates ka vendosur dhenjen e statusit te nepunesit civil gjyqesor(per 13 punonjes). Nuk rezultuan parregullsi ne lidhje me procedurat per dhenjen e statusit te nepunesit civil gjyqesor, punonjesve ne detyre te gjykates.

4.3.2 Mbi procedurat e ndjekura për largimin/lirimin nga puna.

Për periudhën objekt auditimi, janë larguar nga puna 9(nëntë) punonjës, konkretisht: larguar nga puna me kerkese/deshire te punonjesve 4(kater) dhe dale ne pension pleqerie 5(pese).

Me zgjedhje u audituan 5(pesë) dosje punonjesish te larguar nga puna, konkretisht per sekretaret gjyqesore: Zj.Ela Ziu(larguar me deshire/kerkesen e saj); Adelajda Olldashi(larguar me deshire/kerkesen e saj) dhe Xhuljana Elezi(larguar me deshire/kerkesen e saj). Per nepunesin gjyqesor, Z.Njazi Pupa(dale ne pension pleqerie). Per punonjesen e sigurise, Zj.Bukuroshe Agalliu(dale ne pension pleqerie). Nuk rezulton të jetë larguar nga puna asnje punonjes i administrates, per shkelje te disiplines ne pune, per periudhen objekt auditimi. Punonjesit e larguar nga puna, jane larguar me deshire/kerkesen e tyre ose ne pension pleqerie. Ne 5(pesë) dosjet e audituar nuk rezultuan parregullsi ne lidhje me ndërprerjen e marrëdhëneve të punës me punonjesit e larguar.

4.3.3 Etika

Ne referim te Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" dhe Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit te interesit". Ne Rregulloren e Brendshme nr.37 prot, date 22.02.2018 janë të përfshira dhe rregullat e miresjelljes per personelin e admnistrates gjyqesore. Per periudhen objek auditimi nuk rezultuan raste te shkelje te etikes ne pune.

4.3.4 Trajnimi profesional

Gjate vitit 2017 dhe 2018 jane zhvilluar trajnime per gjyqtaret nga Shkolla e Magjistratures dhe Ministria e Drejtesise si dhe trajnime te punonjesve te administrates nga ish ZABGJ ne lidhje me sistemin ICMIC per sekretaret gjyqesore, programin Alfaweb dhe MFK per K/D/Buxhetit etj. Per shkak te pandemise Covid 19, gjate vitit 2019 dhe 2020 nuk janë zhvilluar trajnime për personelin në lidhje me njohjen dhe ndërjegjësimin mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, prokurimin e fondeve publike, menaxhimin e burimeve njerezore etj. Me qëllim rritjen e

kapaciteteve profesionale të stafit/kualifikimin e punonjësve, megjithese nuk rezultuan probleme ne keto fusha.

4.3.5 Mungesa e stafit

Për periudhën objekt auditimi gjykata ka funksionuar bazuar në strukturën organizative të miratuar nga Ministri i Drejtësisë me urdhërin nr.1978, date 16.03.2016, me 29 punonjës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 115, date 05.03.2020, ka miratuar shtesë në organikë me 2(dy) punonjës, konkretisht: 1(një) sekretare regjistruese dhe 1(një) nëpunës gjyqësor(*rekomandim i lene ne auditimin e meparshem*), nga 29 punonjes, organika eshte shtuar në 31 punonjës.

Nga krahasimi i numrit të punonjësve sipas strukturës së miratuar me numrin e punonjësve në fakt, ne fund te muajit dhjetor te vitit 2020, rezulton se numri i punonjësve ne fakt (27) është më i vogël se numri i punonjësve në organikë (31), me pak 4 punonjes, konkretisht:

- KPA me vendimin nr.17, date 15.07.2020 ka shkarkuar nga detyra Kryetarin e Gjykatës, vend i cili aktualisht eshte vakand dhe mbulohet nga zv/Kryetarja e gjykates.

- Me vendimin e KLGJ-se nr.204, date 11.06.2020, 1(nje) gjyqtare eshte transferuar perkohesisht, per nje vit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kavaje.

- Ne datën 21.10.2019, 1(nje) gjyqtare eshte komanduar per 2(dy) vjet ne KLGJ.

- Ne datën 31.01.2020 nje sekretare gjyqesore eshte larguar me deshiren e saj dhe eshte krijuar vendi vakand, per kete periudhe.

- Nje sekretare regjistruese eshte shtuar ne organike dhe nuk ka pas perfunduar procedura gjate kesaj periudhe.

Pozicioni i arkes dhe magazines për periudhën objekt auditimi është mbuluar nga arkivistia e gjykatës. KLGJ-ja ka miratuar dhe gjykata ka filluar proceduren per plotesimin e vendit te punes, magazinier.

Po keshtu jane plotesuar vendet e punes te shtuar/miratuar ne vitin 2020, per 1(nje) sekretare regjistruese dhe 1(nje)nepunes gjyqesore.

Aktualisht, problem ngelet mos plotësimi i trupës gjyqësore, që sjell ngarkesë në punë për gjyqtarët e tjerë dhe zgjatje të çështjeve gjyqësore.

4.3.6 Aftesite profesionale

Gjate intervistave me stafin(kancelarin, k/d/buxhetit, k/sekretaren, sekretaren regjistruese, arkivisten), rezulton se: Njihen proceset e punes dhe nga secili kryhen sipas pershkrimeve te punes ne Rregulloren e Brendshme te Gjykates.

4.3.7 Administrimi i dosjes personale dhe regjistrin themeltar

Sipas të dhënave qe ju paraqitën grupit të auditimit, rezulton se eshte krijuar regjistri themeltar i punonjësve administrativ, në përputhje me nenin 36 “Regjistri”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.136/2015.

Regjistri themeltar i punonjësve është plotësuar në të gjitha referencat e tij, është sekretuar dhe vulosur me vulën e institucionit në të gjitha faqet, gjendja e regjistrin themeltar eshte e mire.

Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 63 “Dosja dhe Reregjistri Qendror i Personelit”, është krijuar regjistri elektronik i

personelit, ka filluar hedhja e të dhënave profesionale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës për punonjësit.

Opinion i përgjithshëm për sistemin e menaxhimit të burimeve njerzore : Sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar mire dhe janë efektive.

4.4 Sistemi i Pagave dhe shpërblimet

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse llogaritjet e pagave janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, si dhe nëse janë të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës, vërtetues e justifikues.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Përputhja e numrit të punonjesve me strukturën organizative të miratuar për periudhën objekt auditimi.
- Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës, elementët e shtesave mbi page, përputhshmëria ligjore për çdo shtesë, saktësia e llogaritjes së tyre.
- Hartimi i listëprezencave dhe listëpagesave.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për pagat jashtë orarit, dhe në ditë pushimi e festash zyrtare.
- Përputhshmëria për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale, sigurimit suplementar, si dhe derdhja e tyre në llogaritë përkatëse.
- Respektimi i dispozitave ligjore mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.

Për auditimin e sistemit të pagave u përdor metoda me zgjedhje rastësore, metoda e testimit hap pas hapi me teknik të auditimit me përzgjedhje nga listë prezencat në listë pagesat e punonjësve, pasqyrimin e tyre në librin e pagave si dhe rakordimi i pagës neto me shumën e hedhur në llogarinë bankare.

Kampioni i përzgjedhur për auditim:

- *Për vitin 2017, pagesat e kryera për muajt: Mars, Prill, Maj*
- *Për vitin 2018, pagesat e kryera për muajt: Janar, Shkurt, Mars*
- *Për vitin 2019, pagesat e kryera për muajt: Maj, Qershor, Korrik*
- *Për vitin 2020 pagesat e kryera për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor*

- *Respektimi i strukturës organike të miratuar për periudhën objekt auditimi*

Për periudhën 2017 deri më 05.03.2020, struktura organike është e miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë n.1477, datë 24.02.2015, me 29 punonjës, organika e gjykatës është shtuar me 2 punonjës me vendimin e KLGJ nr.115 datë 05.03.2020 .

Për vitin 2018 , me VKM nr.60 datë 31.01.2018 gjykatës i janë miratuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme vjetore me kohë pune 4/orë në ditë dhe për vitin 2019 me VKM nr.16, datë 16.01.2019 janë miratuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme vjetore me kohë pune 4 orë/ditë.

Nga auditimi i të dhënave në listëpagesat, duke i kryqëzuar me përcaktimet e emërtimeve në strukturë, për periudhën objekt auditimi, rezulton se është respektuar struktura organizative e miratuar.

- *Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës, elementët e shtesave mbi page, përputhshmëria ligjore për çdo shtesë, saktësia e llogaritjes së tyre.*

Për periudhën e audituar sistemi i pagave në Gjykatë, është bazuar në Ligjin Nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” për trupën gjyqësore deri në 31 Dhjetor 2018, Ligjin Nr.96/2016 “Për Statusin Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, ndryshuar me VKM nr.202, datë 15.03.2017 dhe VKM nr.187, datë 08.03.2017, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit të KLGJ nr.38 datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore për pagat dhe shtesat mbi pagë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë për testim në lidhje shtesat mbi pagë dhe përputhja me aktet ligjore rezultojnë se :

Llogaritja dhe pagesa e shtesës së pagës për vjetërsi në shërbim për trupën gjyqësore dhe vjetërsisë në punë të punonjësve administrativ, është kryer sa vijon:

- ✓ Shtesa e pagës për vjetërsi për trupën gjyqësore është kryer në bazë të shkresës nr.4471/1 datë 23.12.2016, të KLD-së për vjetërsinë e trupës gjyqësore referuar regjistrin të gjyqtarëve.
- ✓ Llogaritjet për pagesën e shtesës së pagës për vjetërsi në punë të punonjësve administrative janë kryer referuar librezave të punës.

Ndryshimet për efekt të rritjes së vjetërsisë në punë si për trupën gjyqësore dhe për administratën janë kryer nga kancelari janë pasqyruar me shkresë zyrtare në fillim të vitit, janë miratuar nga titullari dhe dërguar në zyrën e financës për të kryer përllogaritjet për efekt pagese.

Nga krahasimi i viteve të punës në librezë me përllogaritjet e kryera për shtesë page për efekt të vjetërsisë në punë referuar listëpagesave nuk rezultuan diferenca.

- ✓ Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pagës për “Për natyrë të veçantë pune”, rezultoi se: pagesa për shtesë page për natyrë të veçantë pune është miratuar nga DAP-i, shkresa nr.2311/1 datë 02.06.2016, në masën 5000 lekë në muaj nga specialistja e IT .
- ✓ Në lidhje me pagesat e kryera për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar rezultojnë se: vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar është llogaritur dhe paguar në përputhje me VKM nr.524, datë 16.08.2012, lidhja 2, i ndryshuar, dhe VKM nr.187 datë 01.03.2017.
- ✓ Për pagesën e shtesës të pagës për vështirësi e dëmshmëri në punë për pozicionet e punës: *nëpunës gjyqësor/ftus, sanitare, shofer & mirmbajtës, punonjës sigurie* rezultojnë se; Shtesa për vështirësi e dëmshmëri në punë është dhënë sipas miratimit nga institucionet përkatëse “Mbi miratimin e shkallës së vështirësisë në punë”, (trajtuar në pikën 1.zbatimi i rekomandimeve të lëna).
- ✓ Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës për administratën mbështetëse, nga auditimi rezultojnë se: është zbatuar kategoria e pagave për administratën mbështetëse sipas VKM nr.202, datë 15.03.2017.

- *Hartimi i listëpagesave dhe listëprezencave:*

Nga kampioni i marrë për testim rezultojnë se:

-Prezenca në punë e punonjësve është e dokumentuar me përpilimin e dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë, me listëprezencë.

Listëprezencat janë mbajtur nga kancelari i gjykatës në cilësinë e menaxherit në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP” kreu III-të paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pika 69 dhe 71. kap. V.

Listë pagesat janë hartuar dhe nëshkruar nga k/d/buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues, nga titullari i gjykatës /nëpunësi autorizues, në përputhje me nenin 22, pika 3(c) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2000, “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, i ndryshuar është respektuar sistemi i dy nënshkrimeve.

-Nga krahasimi i numrit të ditëve të pasqyruara në listëprezencë me numrin e ditëve në listëpagesë nuk rezultuan diferenca.

- Nga testimi mbi përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara në bankë sipas punonjësve me pagën neto në listëpagesë, rezulton se: paga neto e pasqyruar në listëpagesë është e njëjtë me pagën neto të pasqyruar në llogarinë personale sipas formatit të listëpagesës së bankës. Pagat e personelit janë pasqyruar në librin e pagave.

- *Zbatimi i dispozitave ligjore për punën e kryer jashtë orari në ditë pushimi e festa zyrtare.*

- Nga sondazhet e kryera në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e orëve jashtë kohës normale të punës, në ditë pushimi e festa zyrtare, rezulton se është vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- *Përputhshmëria për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale si dhe derdhja e tyre në llogaritë përkatëse, sigurimi suplementar.*

Nga auditimi i përlllogaritjeve dhe derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, në të gjitha listë pagesat e punonjësve që u përgjodhën për periudhën që auditohet rezulton se; llogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi pagat dhe të ardhurat personale, është kryer në zbatim të legjislacionit në fuqi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore dhe janë derdhur në Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas afateve të përcaktura ligjore. Llogaritjet janë kryer për çdo punonjës, janë ndaluar nga paga sigurimet Shoqërore e Shëndetësore duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën.

Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen, ndalesën dhe xhirimin e sigurimit suplementar të detyrueshëm për trupën gjyqësore për llogari të Sigurimeve Shoqërore rezultoi se: nuk janë reflektuar ndryshimet nga 3% në 4% , që rrjedhin me hyrjen në fuqi të ligjit 96/2016, në zbatim të nenit 21, pika 1, prej 01.01.2019.

Me urdhërin nr 55, datë 30.06.2020 të Zv/kryetarit të gjykatës për sistemimin e diferencës së krijuar në ndalesën e sigurimit suplementar duke filluar nga data 01.07.2020, dega e buxhetit referuar këtij urdhëri ka kryer sistemimet përkatëse për ndalesën e sigurimit suplementar sipas legjislacionit në fuqi.

e). *Respektimi i dispozitave ligjore mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.*

Nga auditimi i rregullshmërisë në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë u konstatua se fondi i veçantë për periudhën nën auditim është përdorur si vijon:

- 1(një) rast në vitin 2017,(sëmundje) në shumën 50 mijë lekë,
- 1(një) rast në vitin 2018,(për dalje në pension) në shumën 45 mijë lekë,

- 3(tre) raste në vitin 2019,(1 rast fatkeqësi dhe 2 raste dalje në pension) në shumën 164 mijë lekë,
- 2 (dy) raste në vitin 2020,(dalje në pension) në shumën 113 mijë lekë.

Nga auditimi rezulton se janë respektuar drejt dispozitat ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë.

Opinion i përgjithshëm për sistemin e pagave: Grupi i auditimit e vlerëson funksionimin e sistemit të pagesave të punonjësve në përputhshëmri me strukturën e miratuar dhe me dispozitat ligjore të pagave.

Kontrolli i brendshëm ka funksionuar në të gjitha hallkat e këtij sistemi, dhe është efektiv. Risku vlerësohet i ulët.

4.5 Të ardhurat nga tarifat gjyqësore.

Auditimi i të ardhurave nga shërbimet gjyqësore u realizua në zbatim të Ligjit Nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombetare" i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët nr.33 datë 29/12/2014, "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë" dhe në reference edhe të Kodit të Procedures Civile 160/2013 i ndryshuar me ligjin 38/2017, Kreu IV, nenet 102-110.

Situata e arkëtimeve nga shërbimet gjyqësore, dhe të ardhurat që përfiton gjykata për periudhën objekt auditimi paraqitet si vijon:

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020		
		Totali	I përkasin buxhetit (90%)	I përkasin gjykatës (10%)	Totali	I përkasin buxhetit (90%)	I përkasin gjykatës (10%)	Totali	I përkasin buxhetit (90%)	I përkasin gjykatës (10%)	Totali	I përkasin buxhetit (90%)	I përkasin gjykatës (10%)
1	Të ardhura nga tarifa me pulla takse	3,563,000	3,206,700	356,300	3,607,000	3,246,300	360,700	4,080,000	3,672,000	408,000	3,279,500	2,951,550	327,950
2	Të ardhura tarifa 1% i kërkesë padive	4,690,577	4,221,519	469,058	2,676,475	2,408,827	267,648	1,117,714	1,005,943	111,771	806,325	725,692	80,633
	Shuma:	8,253,577	7,428,219	825,358	6,283,475	5,655,127	628,348	5,197,714	4,677,943	519,771	4,085,825	3,677,242	408,583

U audituan me zgjedhje dosjet e çështjeve civile për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2020, për saktësinë e përlllogaritjes së tarifës gjyqësore, arkëtimin në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët nr.33 datë 29/12/2014 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë" shtojca nr.1.

Në kampion u përzgjedhën me metodën e përzgjedhjes rastësore 1100 dosje të vendimuara e të arshivuara duke u shtrirë në të gjithë periudhën audituese.

Në kampionin e përzgjedhur konstatohet tarifa gjyqësore është përlllogaritur dhe arkëtuar në momentin e pranimit të kërkesë padive në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët nr.33 datë 29/12/2014 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë".

Gjetje nga auditimi Nr.2: Në 514 dosje të kampionit të mësipërm me objekt padie "zgjidhje martese", në 23 prej tyre objekti i padisë është trajtuar si "kërkesë" dhe tarifa gjyqësore është llogaritur dhe arkëtuar në vlerën 200 lekë (me pullë) konkretisht: (Vendimi nr.137,datë 20.02.2017, vendimi nr.669 datë 11.07.2017,vendimi nr.997 datë 15.11.2017, vendimi nr.1138 datë 20.12.2017, vendimi nr.103 datë

05.02.2018, vendimi nr.104, datë 05.02.2018, vendimi nr.106 datë 06.02.2018, vendimi nr. 421 datë 16.05.2018, vendimi nr.879 datë 05.11.2018, vendimi nr. 986 datë 06.12.2018, vendimi nr. 1012 datë 14.12.2018, vendimi nr. 1063 datë 26.12.2018, vendimi nr. 76 datë 29.01.2019, vendimi nr. 93 datë 04.02.2019, vendimi nr. 209 datë 05.03.2019, vendimi nr. 427 datë 07.05.2019, vendimi nr.443 datë 09.05.2019, vendimi nr. 646 datë 25.06.2019, vendimi nr. 753 datë 22.07.2019, vendimi nr.863 datë 26.09.2019, vendimi nr. 1004 datë 05.11.2019, vendimi nr. 1185 datë 16.12.2019, vendimi nr 843 datë 21.12.2020) duke mos arkëtuar vlerën 64.400 lekë.

Tarifa e aplikuar në këto raste nuk është në përputhje me udhëzimin nr.33, datë 29/12/2014 shtojca nr.1 pika 8, gërma c (ku citohet tarifa për padi zgjidhje martese është 3000 lekë). Në këtë udhëzim nuk ka tarifë të përcaktuar për kërkes miratim zgjidhje martese.

Rekomandimi Nr.2: Menaxherët e gjykatës të rishikojnë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke hartuar dhe miratuar një procedurë të qartë (gjurmën e auditit) ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka lidhje me përlllogaritjen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore, si dhe mënyren e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi.

Nga dega e buxhetit të ardhurat e realizuara çdo muaj janë deklaruar në sistemin tatimor nëpërmjet formularit të deklarimit brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.33 datë 29.12.2014 dhe janë derdhur në favor të buxhetit të shtetit në llogaritë përkatëse të sistemit thesarit.

Për të ardhurat e realizuara nga tarifa gjyqësore dhe shërbimet e tjera gjyqësore janë kryer rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit dhe janë pasqyruar edhe në situacionet mujore dhe vjetore.

Masa e përfitimit nga tarifa gjyqësore prej 10% është llogaritur kontabilizuar dhe përdorur nga gjykata nëpërmjet rritjes së autorizimeve me miratim nga dega e thesarit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përdorimi i të ardhurave nga gjykata paraqitet si vijon:

Në lekë

Përshkrimi	Llog. Ekon.	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Pjesa e gjykatës (10%)	Përdorimi	Pjesa e gjykatës (10%)	Përdorimi	Pjesa e gjykatës (10%)	Përdorimi	Pjesa e gjykatës (10%)	Përdorimi
Të ardhura nga tarifa gjyqësore		825,358		628,348		519,771		408,583	
- Për investime	231		439,180		290,656		180,000		274,200
- Shpenzime operative	602		270,061		250,000		198,000		0
Shuma:		825,358	709,241	628,348	540,656	519,771	378,000	408,583	274,200
Pa përdorur/derdhur në buxhet			116,117		87,692		141,771		134,383

Të ardhurat që i përkasin gjykatës dhe të papërdorura deri më 31/12/2020 janë transferuar në buxhetin e shtetit.

Opinion i përgjithshëm për sistemin e të ardhurave: Sistemi i kontrollit të brendshëm ka nevojë për përmirësim në monitorimin e aplikimit të tarifave gjyqësore është pjesërisht efektiv. Risku vlerësohet i mesëm

4.6 Sistemi i prokurimeve

4.6.1 Sistemi i prokurimeve me vlerë të lartë

Autoriteti Kontraktor në fillim të vitit ka caktuar personin përgjegjës për prokurimet dhe ka dërguar informacion për personin përgjegjës për prokurimet në APP, konkretisht: për periudhën objekt

auditimi, personi përgjegjes për prokurimin është caktuar me: Urdherin nr.10, datë 08.01.2020; nr.7, datë 07.01.2019 dhe nr.10, datë 12.01.2018. Informacioni për personin përgjegjes për prokurimet në APP është dërguar me shkresën nr.138, prot. datë 28.01.2020; nr.243, prot. datë 31.01.2019 dhe nr.13, prot. datë 16.04.2018.

Në bazë të kërkesave për punë, mallra dhe shërbime, njesia e prokurimit është krijuar me urdher të veçantë nga kryetari i autoritetit kontraktor (nr.12, datë 09.01.2020), në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikimeve për prokurimet, ka përgatitur dhe dorëzuar regjistrin vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja është dërguar në Degën e Thesarit dhe në organin qendror që ka vënë në dispozicion fondet buxhetore. Autoriteti kontraktor në rastet e justifikuara ka bërë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit. Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit nga APP-ja është dërguar në Degën e Thesarit dhe në organin qendror që ka vënë në dispozicion fondet buxhetore.

Autoriteti kontraktor, në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës ka pasqyruar procedurën në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë për procedurat e prokurimit u përqendrua kryesisht në segmente të tenderimit, konkretisht: mbi vlerën e prokurimit të parashikuar (në RPPP) krahasuar me vlerën e prokuruar (fondin limit) dhe vlerën e realizuar (vlerën e fituar/kontratës); në hartimin/sigurimin e specifikimeve teknike/termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit; në argumentimin e kriterëve të veçantë të kualifikimit; hartimin e dokumentave të tenderit; në përzgjedhjen e fituesve për kontrata publike për mallra, punë dhe shërbime; në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të ofertuesve fitues; në administrimin dhe arkivimin e dosjes së tenderit.

Nga auditimi mbi prokurimet publike për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

- Sipas RPPP dhe RRPP, Autoriteti Kontraktor, për vitin 2020 nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë procedurë prokurimi me vlerë të lartë.

- Për vitin 2019 është parashikuar dhe realizuar 1 (një) procedura prokurimi me vlerë të lartë "Kërkese për propozim"- Mareveshje kuader, me objekt prokurimi: "Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes së godines", në vlerën 2 333 333 leke pa tvsh dhe 2 800 000 leke me tvsh.

- Për vitin 2018 janë parashikuar dhe realizuar 3 (tre) procedure prokurimi me vlerë të lartë "Kërkese për propozim", konkretisht: "Rikonstruksion i godines", në vlerën 833 333 leke pa tvsh dhe 1 000 000 leke me tvsh; "Blerje pajisje elektronike", në vlerën 1 475 000 leke pa tvsh dhe 1 770 000 leke me tvsh; "Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes së godines", në vlerën 2 084 167 leke pa tvsh dhe 2 501 000 leke me tvsh.

- Për vitin 2017 është parashikuar dhe realizuar 1 (një) procedura prokurimi me vlerë të lartë "Kërkese për propozim", me objekt prokurimi: "Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes së godines", në vlerën 1 984 000 leke pa tvsh dhe 2 379 723 leke me tvsh.

Gjatë periudhës objekt auditimi, autoriteti kontraktor ka realizuar 5 (pesë) procedure prokurimi me vlerë të lartë, nga grupi i auditimit u audituan 2 (dy) ose 40% të procedurave të realizuar, konkretisht:

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Nr	Viti	Objekti i prokurimit	Vlera në lekë e prokuruar me tvsh	Vlera në lekë e fituar me tvsh	Diferenca +/-	Llojë i procedurës
1	2020	-	-	-	-	-
2	2019	Sherbime sigurie	2 800 000	2787333	-12 667	Kërkesë për propozim
3	2018	Rikonstruksion i godines	999 600	719 244	- 280 356	Kërkesë për propozim
4	2018	Blerje pajisje elektronike	1 770 000	1 667 256	- 102 744	Kërkesë për propozim
5	2017	Sherbime sigurie	2 379 723	2 379 723	0	Kërkesë për propozim
Totali			7 949 323	7 553 556	- 395 767	

Nga analiza e prokurimeve me vlerë të lartë të realizuar nga autoriteti kontraktor dhe të audituar nga grupi auditimit, rezulton se: Vlera e prokuruar/**fondi limit i llogaritur** (7949323 lekë me tvsh) krahasuar me vlerën e realizuar/**vlera e fituar/kontratës** (7553556 lekë me tvsh), me pak/kursim - **395 767 leke me tvsh** (7 949 323 - 7 553 556), që tregon se ka pasur konkurrence midis operatoreve ekonomik pjesmarres ne procedurat e prokurimit te zhvilluar nga autoriteti kontraktor.

Per tenderat e audituar, ne perfundim te auditimit dhe ballafaqimeve gjendja paraqitet si me poshte:

1. Tenderi i zhvilluar ne ruge elektronike me objekt prokurimi **“Rikonstruksion i pjesshem i godines se Gjykates te Rrethit Gjyqesor Berat”**, realizuar ne vitin 2018 me proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim”, me pjesmarrje ne konkurim te 3(tre) OE, nga keto: 2(dy) te kualifikuar dhe 1(nje) te skualifikuar, pa ankesa per dokumentat e tenderit dhe per vleresimin dhe klasifikimin e ofertave dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.17 Datë 14.06.2018. 2.Fondi limit -pa tvsh 833 000 leke. -me tvsh 999 600 leke. 3.Pr.Prok. “Kerkese per propozim“ , ne SPE. 4.Data e zhvillimit te tenderit 06.07.2018. 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi “FLORJON” shpk. 7.Data e lidhjes te kontratës 26.07.2018. 8.Vlera e kontratës - pa tvsh 599 370 leke. - me tvsh 719 244 leke. 9.Difer.mes f.limit e kont.- 280 356 lekë me tvsh. 10.Lik.kont. 719 244 leke ose 100% te vleres.	1.Merita Shehu, Kryetare 2.Magletina Kosova, Anetare 3.Lulzim Sino, Anetare	1. Arjona Firaj, Kryetare 2. Eftali Shandro, Anëtare 3.Eugen Kallfani, Anëtare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Autoriteti Kontraktor per vitin 2018, ka parashikuar ne RPPP per te zhvilluar proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim”, me objekt prokurimi “Rikonstruksion i pjesshem i godines se Gjykates te Rrethit Gjyqesor Berat”, ne vleren 833 333 lekë pa tvsh.

Ne mbeshitetje te kerkeses te kancelarit te gjykates Nr.107 prot. date 06.06.2018, te miratuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor me Nr.107/1 prot. date 06.06.2018, ky i fundit ka nxjerrë urdherin e brendshem me nr.108 prot. date 06.06.2018 per ngritjen e komisionit per hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit.

Ne mbeshitetje te urdherit te mesiperm, komisioni i ngritur per kete qellim, ne perberje te te cilit eshte dhe nje inxhinjer arkitekt, ky i fundit sipas planimetrise te godines(kati pare dhe i dyte), ka hartuar specifikimet teknike, grafikun e punimeve dhe preventivin e punimeve, ne baze te te cilave eshte perlllogaritur dhe fondi limit, ne vleren 833 000 leke pa tvsh dhe 999 600 leke me tvsh, dokumentuar ne procesverbalin Nr.1, date 14.06.2018. Fondi limit eshte perlllogaritur sipas cmimeve normative dhe standarteve te percaktuara ne VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre”, ne baze te te cilave eshte hartuar dhe preventive i punimeve ne vleren 833 000 leke pa tvsh dhe 999 600 leke me tvsh, relatuar nga komisioni i ngritur per kete qellim dhe miratuar nga K/AK.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Në Urdhër Prokurim nr.prot.17 datë 14.06.2018 eshte ngritur njesia e prokurimit ku dhe eshte percaktura që procedura e prokurimit do të jetë “Kerkese per propozim”. Gjithashtu eshte percaktuar qe fondi limit per objektin e prokurimit “Rikonstruksion i pjesshem i godines se Gjykates te Rrethit Gjyqesor Berat”, do te jete 833 000 leke pa tvsh.

Ne mbeshitetje te nenit 61 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, NjP ka hartuar dokumentat e tenderit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit), dokumentuar ne procesverbalin Nr.2, date 20.06.2018, miratuar nga K/AK.

Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne SPE ka hedhur Dokumentat e Tenderit bashke me Formularin e Njoftimit te Kontrates nr.prot.113, date 22.06.2018, si dhe janë ftuar 5 OE, te perzgjedhur me pare nga NjP per te marre pjese ne konkurim.

Dokumentat e tenderit dhe Njoftimi i Kontrates jane Publikuar ne faqen e APP-se në daten 25.06.2018 dhe ne Buletinin e APP-se Nr.26, date 02.07.2018.

Per dokumentat e tenderit nuk ka pasur ankesa.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin e K/AK nr.69 date 14.06.2018 eshte ngritur KVO-ja. Sipas njoftimit te kontrates te publikuar ne Buletinin e APP-se, personi i autorizuar ka mbyllur ne SPE fazen e dorezimit te ofertave në oren dhe daten e publikuar, date 06.07.2018.

Sipas procesverbalit Nr.3, date 06.07.2018 “Per hapjen e procedures te prokurimit”, rezulton te kene marre pjese ne konkurim 3 OE.

1. “FLORJON” shpk.
2. “ELDA-VL” shpk.
3. “HARMONIA” shpk.

Sipas procesverbalit nr.4, date 11.07.2018 dhe nr.5, date 13.07.2018 per “Shqyrtimin dhe vleresimin e dokumentacionit ligjor, administrative, teknik, te paraqitura nga shoqerite pjesmarrese dhe klasifikimi i operatoreve ekonomike pjesmarres. KVO-ja, ka kualifikuar 2(dy) OE dhe skualifikuar 1(nje) OE, per

mos plotesimin e kritereve te veçanta per kualifikim te vendosura nga AK dhe paraqitjen e ofertes ekonomike me vlere 0.

1. "FLORJON" shpk., me vlere oferte 599 370 leke pa tvsh, kualifikua.
2. "ELDA-VL" shpk, me vlere oferte 0, skualifikuar.
3. "HARMONIA" shpk., me vlere oferte 719 550 leke pa tvsh, kualifikuar.

Oferta e dorezuar nga OE "FLORJON" shpk., ne vleren 599 370 leke pa tvsh, rezulton te jete anomalisht e ulet(28% me e ulet se fondi limit), per kete KVO i eshte drejtuar zyrtarisht OE duke i kerkuar sqarime me shkrim ne lidhje me vleren e paraqitur ne oferte. OE ka derguar dokumentacionin me analizat perkatese te cmimeve te vendosura ne oferte. KVO i ka vleresuar te drejta argumentat e dhena dhe e ka vleresuar te vlefshme oferten e paraqitur duke kualifikuar OE.

Klasifikimi perfundimtare ne SPE eshte bere ne daten 13.07.2018.

Per vleresimin dhe klasifikimin e ofertave nuk ka pasur ankesa.

Komisioni i vleresimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit ne daten 20.07.2018 ka përgatitur raportin përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vleresimit të ofertave dhe i ka propozuar titullarit të autoritetit kontraktor te shpall fitues operatorin ekonomik "FLORJON" shpk., me vlere oferte 599 370 leke pa tvsh, miratuar nga K/AK me nr.prot.120, date 20.07.2018.

Po ne kete date eshte plotesuar dhe derguar/hedhur ne SPE Formulari i Njoftimit te Fituesit me nr.prot.122 date 20.07.2018, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.30, date 30.07.2018.

VI. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në procedurën e prokurimit.

Perpara se te lidhet kontrata, nga KVO eshte bere vleresimi i dokumentave fizik dorezuar ne forme shkresore nga Operatori Ekonomik i shpallur fitues. Nga krahasimi i dokumentave te hedhura ne SPE me dokumentat e dorezuara ne forme shkresore nuk rezultuan ndryshime.

Sipas formularit te sigurimit te kontrates, sigurimi i kesaj te fundit eshte bere ne daten 25.07.2018, ne vleren 71 925 leke ose 10% te vleres totale te kontrates.

Mbas sigurimit te kontrates dhe marrjes ne dorezim te dokumentave fizik nga KVO-ja, me OE "FLORJON" shpk., është lidhur Kontrata me nr.prot.128 date 26.07.2018 ne vleren 599 370 leke pa tvsh dhe 719 244 leke me tvsh.

Formulari i Njoftimit te Kontrates te nenshkruar eshte plotësuar me nr.prot 124 date 26.07.2018, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.31, date 06.08.2018.

Ne zbatim te njoftimit te APP-se nr.5663/1, date 28.05.2018, AK ka plotesuar dhe derguar ne APP, Formularin e raportimit per zbatimin e kontrates, date 26.07.2018.

Per mbikqyrjen e punimeve eshte lidhur kontrata nr.126, date 26.07.2018,ne vleren 17 720 leke me tvsh, me Inxhinjerin e ndertimit Lefter Ndrio, sipas procedure se blerjeve me vlere nen 100 000 leke pa tvsh te zhvilluar ne daten 26.07.2018. Ne zbatim te VKM nr.354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projekti,mbikqyrje dhe kolaudim".

Nga mbikqyresi i punimeve eshte dorezuar dosja teknike me te gjithë dokumentacionin perkates. Ne daten 27.07.2018, eshte hartuar procesverbali per punimet e realizuara dhe punimet e maskuara, nenshkruar nga sipermarresi i punimeve dhe mbikqyresi i punimeve.

Situacioni perfundimtare eshte nenshkruar nga Investitori, zbatasi i punimeve dhe mbikqyresi i punimeve. Relacioni perfundimtare per mbikqyrjen e punimeve eshte hartuar ne daten 28.08.2018.

Kontrata per kolaudimin e punimeve nr.129, date 26.08.2018, ne vleren 1417 leke me tvsh. Procesverbali kolaudimit nr.1, date 31.08.2018.

Sipas urdherit nr.72, date 31.08.2018 per "Marrjen ne dorezim te punimeve te rikonstruksionit te godines", komisioni i ngritur per kete qellim, ka evidentuar ne Certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve te dates 31.08.2018, se punimet jane bere sipas kerkesave te AK.

Sipas Ush nr.209, date 26.09.2018 eshte paguar OE "Florjon" shpk ne vleren 683 282 leke(-35962 leke, garancia e punimeve)

Dosja e tenderit eshte sistemuar, inventarizuar dhe dorëzuar ne arkiven e gjykates, protokolluar me Nr.158 prot, date 21.12.2018.

2. Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt prokurimi "**Blerje pajisje elektronike**", realizuar ne vitin 2018 me proceduren e prokurimit "Kerkese per propozim", me pjesmarrje ne konkurim te 3(tre) OE, nga keto: 1(nje) i kualifikuar dhe 2(dy) te skualifikuar, pa ankesa per dokumentat e tenderit dhe per vleresimin dhe klasifikimin e ofertave dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.11 Datë 14.05.2018. 2.Fondi limit -pa tvsh 1 475 000 leke. -me tvsh 1 770 000 leke. 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim", ne SPE. 4.Data e zhvillimit te tenderit 31.05.2018. 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "BNT Elektroniks" shpk. 7.Data e lidhjes te kontratës 25.06.2018. 8.Vlera e kontratës - pa tvsh 1 389 380 leke. - me tvsh 1 667 256 leke. 9.Difer.mes f.limit e kont.- 102 744 lekë me tvsh. 10.Lik.kont. 1 667 256 leke ose 100% te vleres.	1.Merita Shehu, Kryetare 2.Magletina Kosova, Anetare 3.Kristina Llupa, Anetare	1. Arjona Firaj, Kryetare 2. Eftali Shandro, Anëtare 3.Zhanklina Ikonomi, Anëtare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Autoriteti Kontraktor per vitin 2018, ka parashikuar ne RPPP per te zhvilluar proceduren e prokurimit "Kerkese per propozim", me objekt prokurimi "Blerje pajisje elektronike", ne vleren 1 475 000 leke pa tvsh, për:

- 1 cope UPS Serveri 3000 VA
- 4 cope Kompjutera Desktop 2
- 3 cope UPS 1000 VA
- 1 cope Fotokopje B&W MFP Basic
- 1 cope Skaner Tip 2
- 3 cope Printera B&W advanced
- 1 cope Server

Nga K/AK është nxjerrë urdheri i brendshem me nr.prot.93, date 09.05.2018 per ngritjen e komisionit per hartimin e specifikimeve teknike dhe perlogaritjen e fondit limit.

Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni i ngritur per kete qellim ka siguruar nga AKSHI specifikimet teknike si dhe ka perlogaritur fondin limit, ne vleren 1 475 000 leke pa tvsh,

dokumentuar ne procesverbalin Nr.1, date 14.05.2018. Fondi limit eshte perlogaritur me cmimet e references sipas specifikimeve teknike te publikuara nga AKSHI per pajisjet elektronike te vitit 2018.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Në Urdhër Prokurim nr.prot.157 datë 05.04.2018 eshte ngritur njesia e prokurimit ku dhe eshte percaktura që procedura e prokurimit do të jetë “Kerkese per propozim”. Gjithashtu eshte percaktuar qe fondi limit per objektin e prokurimit “Blerje pajisje elektronike”, do te jete 1 475 000 leke pa tvsh. Ne mbeshtetje te nenit 61 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, NjP ka hartuar dokumentat e tenderit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit), dokumentuar ne procesverbalin Nr.2, date 18.05.2018, miratuar nga K/AK.

Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne SPE ka hedhur Dokumentat e Tenderit bashke me Formularin e Njoftimit te Kontrates nr.prot.97, date 18.05.2018, si dhe janë ftuar 5 OE, te perzgjedhur me pare nga NjP per te marre pjese ne konkurim.

Dokumentat e tenderit dhe Njoftimi i Kontrates jane Publikuar ne faqen e APP-se në daten 21.05.2018 dhe ne Buletinin e APP-se Nr.21, date 28.05.2018.

Per dokumentat e tenderit nuk ka pasur ankesa.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin e K/AK nr.60 date 14.05.2018 eshte ngritur KVO-ja. Sipas njoftimit te kontrates te publikuar ne Buletinin e APP-se, personi i autorizuar ka mbyllur ne SPE fazen e dorezimit te ofertave në oren dhe daten e publikuar, date 31.05.2018.

Sipas procesverbalit Nr.3, date 31.05.2018 “Per hapjen e procedures te prokurimit”, rezulton te kene marre pjese 3 OE,

1. “PC Store” shpk.
2. “Atom Compjuter” shpk.
3. “BNT Elektroniks” shpk.

Sipas procesverbalit nr.4, date 06.06.2018 per “Shqyrtimin dhe vleresimin e dokumentacionit ligjor, administrative, teknik, te paraqitura nga shoqerite pjesmarrese dhe klasifikimi i operateve ekonomike pjesmarres. KVO-ja, ka kualifikuar 1(nje) dhe skualifikuar 2(dy) OE, per mos plotesimin e kriterëve te veçanta per kualifikim te vendosura nga AK.

1. “PC Store” shpk, me vlere oferte 1 439 500 leke pa tvsh, skualifikuar.
2. “Atom Compjuter” shpk, me vlere oferte 1 224 000 leke pa tvsh, skualifikuar.
3. “BNT Elektroniks” shpk, me vlere oferte 1 389 380 leke pa tvsh, kualifikuar.

Klasifikimi perfundimtare ne SPE eshte bere ne daten 07.06.2018.

Per vleresimin dhe klasifikimin e ofertave nuk ka pasur ankesa.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit ne daten 18.06.2018 ka përgatitur raportin përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe i ka propozuar titullarit të autoritetit kontraktor te shpall fitues OE “BNT Elektroniks” shpk, me vlere oferte 1 389 380 leke pa tvsh, miratuar nga K/AK me nr.prot.111, date 18.06.2018.

Po ne kete date eshte plotesuar dhe derguar/hedhur ne SPE Formulari i Njoftimit te Fituesit me nr.prot.111/1 date 18.06.2018, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.25, date 25.06.2018.

VI. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në procedurën e prokurimit.

Perpara se të lidhet kontrata, është bërë vlerësimi i dokumentave fizik, dorëzuar në mënyrë shkresore nga Operatori Ekonomik i shpallur fitues, "BNT Elektroniks" shpk. Nga krahasimi i dokumentave të hedhura në SPE me dokumentat e dorëzuara në mënyrë shkresore nuk rezultuan ndryshime.

Sipas formularit të sigurimit të kontrates, sigurimi i kësaj të fundit është bërë në datën 20.06.2018, në vlerën 166 726 leke ose 10% të vlerës totale të kontrates.

Mbas sigurimit të kontrates dhe marrjes në dorëzim të dokumentave fizik nga KVO-ja, me OE "BNT Elektroniks" shpk, është lidhur Kontrata me nr.prot.987 datë 25.06.2018 në vlerën 1 389 380 leke pa tvsh dhe 1 667 256 leke me tvsh.

Sipas urdherit nr.71, datë 25.06.2018 për "Marrjen në dorëzim të mallit", komisioni i ngritur për këtë qëllim, ka evidentuar në procesverbalin e datës 06.07.2018 se malli është marrë në dorëzim brenda afatit të percaktuar në kontratë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara.

Formulari i Njoftimit të Kontrates të nënshkruar është plotësuar me nr.prot 115/2 datë 25.06.2018, publikuar në Buletinin e APP-se Nr.26, datë 02.07.2018.

Nga personi përgjegjës për prokurimet është plotësuar dhe dërguar në APP, Formulari i raportimit për zbatimin e kontrates Nr.987 prot., datë 25.06.2018.

Sipas listës të dokumentacionit, rezultoi se dosja e tenderit është sistemuar, inventarizuar dhe dorëzuar në arkivën e gjykates me Nr.117 prot, datë 30.06.2018.

4.6.2 Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël

Në mbështetje të nenit 29, pika 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Nenit 40, pika 3, Kreu IV të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Pikës 2 të Udhëzimit Nr.3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. Kryetari i AK, në fillim të çdo viti kalendarik, objekt auditimi ka ngritur komisionin e prokurimit me vlerë të vogël, që ka funksionuar për gjithë vitin, konkretisht me: Urdherin Nr.2, datë 06.01.2017; Nr.3, datë 05.01.2018; Nr.4, datë 04.01.2019 dhe Nr.5, datë 07.01.2020, i ndryshuar me urdherin nr.51, datë 05.06.2020.

Gjithashtu në fillim të çdo viti kalendarik, objekt auditimi është krijuar komisionin i marrjes në dorëzim të mallrave/puneve/sherbimeve, që ka funksionuar rregullisht për gjithë vitin, konkretisht me: Urdherin Nr.3, datë 06.01.2017; Nr.4, datë 05.01.2018; Nr.5, datë 04.01.2019 dhe Nr.6, datë 07.01.2020.

Për vitin 2020, janë parashikuar për të zhvilluar 27 procedura, me fond limit 4 283 mijë leke me tvsh, në fakt janë realizuar 27 procedura, me vlerë kontrate 4 015.5 mijë leke me tvsh, nga keto: 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël, të realizuar në SPE, në vlerën 3 127.7 mijë lekë dhe 15 procedura të realizuara në mënyrë shkresore, në vlerën 887.7 mijë lekë (me vlerë deri në 100 000 leke me tvsh në vit).

Grupi i auditimit, vlerësoi për të audituar 20 procedura, ose 74 % të procedurave të realizuara nga autoriteti kontraktor gjatë vitit 2020, në vlerën 2 004.8 mijë leke, nga keto: 10 procedura prokurimi me vlerë të vogël, realizuar në SPE, në vlerën 1 836.6 mijë leke dhe 10 procedura të realizuar në mënyrë shkresore, në vlerën 168.1 mijë leke (me vlerë deri në 100 000 leke pa tvsh në vit).

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nga 100 000 - 800 000 lekë pa tvsh, të realizuara në SPE dhe të audituara nga grupi i auditimit:

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Nr	Objekti i shpenzimit	Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
		Nr	Data	
1	Sherbim printimi/mars	65	02.06.2020	80468
2	Blerje dokumentacioni	95	17.06.2020	32400
3	Blerje leter A3 dhe A4	97	17.06.2020	106666
4	Blerje karburanti	99	10.07.2020	499152
5	Blerje pjese kembimi	116	16.07.2020	114000
6	Blerje kancelari	117	16.07.2020	102960
7	Blerje kondicioner	147	01.09.2020	198000
8	Blerje pajisje elektronike	148	04.09.2020	372000
9	Blerje pajisje zyre	150	11.09.2020	246000
10	Blerje dokumentacioni	161	23.09.2020	85000
	Totali për vitin 2020 :			1 836 646

Procedurat e prokurimit me vlere te vogel deri 100 000 leke pa tvsh, realizuar në menyre shkresore dhe të audituara nga grupi auditimit:

Nr	Objekti i shpenzimit	Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
		Nr	Data	
1	Siguracion motorri	5	27.01.2020	6,678
2	Internet/12 muaj	39	18.03.2020	3,520
3	Siguracion automjeti	64	06.05.2020	18,795
4	Blerje materiale pastrimi	66	06.05.2020	19,200
5	Blerje materiale dezifektimi	63	02.06.2020	17,040
6	Blerje materiale paj. speciale	67	02.06.2020	11,724
7	Shpenzime larje makine	77	03.06.2020	8,400
8	Blerje materiale dezifektimi	115	16.07.2020	34,000
9	Mirembajte MZSH	135	05.08.2020	30,000
10	Siguracion makine	166	08.10.2020	18,795
	Totali për vitin 2020:			168 152

Nga verifikimi në sistemin elektronik dhe dokumentacionit përkatës, rezulton se: Autoriteti Kontraktor në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” dhe Udhëzimin Nr.1, date 14.04.2017 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik”, shfuqizuar me Udhëzimin Nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar. Manualin Teknik “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik”, ka zhvilluar dhe realizuar procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. Për funksionimin e sistemit të prokurimeve me vlerë të vogël, nga grupi auditimit janë plotësuar pyetësorët përkatës për periudhën objekt auditimi 2017,2018,2019 dhe 2020(pjesë evidencës/shënimeve të auditit).

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të realizuar nga Autoriteti Kontraktor dhe të audituar nga grupi auditimit, rezultoi se: nuk u konstatuan parregullsi është ndjekur gjurma e auditit.

Opinion i përgjithshëm për sistemin e prokurimeve me vlerë të lartë dhe vlerë të vogël:
Sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar mirë dhe janë efektive.

4.7 Sistemi i raportimit financiar dhe kontabilitetit

1. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit

Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare për periudhën e audituar është realizuar në programin financiar alphaweb i cili gjeneron të dhëna në përputhje me standartet e pranuar të kontabilitetit në sektorin publik.

Në kampionin për auditim u përzgjedhën 295 Urdhër Shpenzime sipas periudhave kohore, vlerës së pagesës/shpenzimit (për vitin 2017 kampioni 33 U.Shpenzimi, për vitin 2018 kampioni 98 U.Shpenzimi, për vitin 2019 kampioni 62 U.Shpenzimi, për vitin 2020 kampioni 102 U.Shpenzimi). Njëkohësisht për ekzaminim u përzgjedhën me zgjedhje dokumentacioni, magazines (52 fletë dalje) dhe i plotë dokumentacioni i arkës.

Nga auditimi i llogarive kontabël konstatohet se rregjistrimet e kryera janë bazuar në dokumentacionin original të faturave të blerjeve, flet hyrjeve, flet daljeve, mandate arkëtimeve, mandate pagesave, listpagesave dhe dokumentacionit justifikues të tyre.

Vlerat e regjistruara në kontabilitet të ngjarjeve ekonomiko dhe transaksioneve të lidhura me to janë të barabarta me dokumentacionin bazë. U krye kryqëzimi i dokumentacionit të blerjeve me hyrjet në magazinë dhe pagesat e realizuara për to dhe konstatohet se vlerat e tyre janë të barabarta. (faturë blerje malli/shërbimi, flet hyrjet e magazines, urdhërshpenzimi).

Ngarjet ekonomike të ndodhura janë të regjistruara në llogari kontabile dhe nuk u konstatuan ngjarje ekonomike të pa regjistruara.

Urdhër shpenzimet për pagesat e kryera kanë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës dhe janë nënshtruar kontrollit të thesarit dhe mbajnë nëshkrimin e punonjësit thesarit dhe vulën e degës thesarit. Për veprimet ekonomike – financiare (akordim fondesh buxhetore, arkëtime nga shërbimet gjyqësore, pagesave, derdhjeve në buxhet) të kryera janë realizuar akt-rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit. Akt-rakordimet janë të nënshkruar nga dega e thesarit dhe KDBuxhetit dhe Kryetari i gjykatës (N.Zbatues dhe N.Autorizues).

Sipas akt rakordimeve vlera e pagesave të bankës dhe vlera e pagesave sipas të dhënave të degës thesarit për çdo vit ushtrimor rezultojnë të barabartë dhe konkretisht për vitin 2017 në shumën 44 472 810 lekë, për vitin 2018 në shumën 47 663 870 lekë, për vitin 2019 në shumën 53 984 995 lekë, për vitin 2020 në shumën 51 738 886 lekë.

Nga auditimi i veprimeve të arkës konstatohet se kryerja e veprimeve në Cash vjen nga arkëtimi i tarifës gjyqësore nëpërmjet pullave dhe shërbimeve të tjera që kryen administrata gjyqësore.

Veprimet e arkës janë të regjistruar në kontabilitet dhe në librin e arkës sipas veprimeve të ndodhura.

Veprimet me vlera të tjera pranë arkës (pullat e taksës) janë pasqyruar në kontabilitet sipas veprimeve të ndodhura.

Në llogarinë e vlerave të tjera pranë arkës janë pasqyruar tërheqjet nga dega e tatimeve dhe daljet nga kryerja e shërbimeve gjyqësore sipas akteve ligjore në fuqi.

Vlerat monetare dhe pullat e taksës janë inventarizuar cdo fund muaji në përputhje me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP" i ndryshuar.

Për pullat e taksës për cdo vit ushtrimor janë kryer akt rakordimet me DRT Berat të cilët janë të nënshkruara nga përfaqësuesit përkatës.

Daljet e aktiveve nga magazina janë kryer mbi bazën e urdhër dorzimeve të lëshuara nga kancelari. Flet Daljet janë të nënshkruara nga magazinjeri dhe marrësi i mallit. Flet Daljet janë të regjistruara në kontabilitet.

• **Të ardhurat**

U audituan të ardhurat për periudhën 2017-2020 dhe konstatohet se burimi i tyre është kryesisht buxheti të shtetit dhe të ardhurat jashtë limitit që vijnë nga kryerja e shërbimeve gjyqësore në masën 10% të vlerës së tyre sipas përcaktimeve ligjore.

Fondet e buxhetit janë regjistruar në kontabilitet në llogaritë përkatëse duke pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse (*shtesat dhe pakësimet*) gjatë vitit.

Të ardhurat nga shërbimet gjyqësore janë regjistruar në kontabilitet nëpërmjet veprimeve të arkës (CASH) për shërbimet e kryera me tarifë fikse nëpërmjet pullave të taksës dhe nëpërmjet bankës për tarifën e shërbimit me përqindje (1% të vlerës së padisë). (trajtuar tek të ardhurat nga shërbimet gjyqësore)

Të ardhurat që i përkasin gjykatës (10%) dhe ato që i përkasin buxhetit të shtetit janë regjistruar të ndara në kontabilitet në momentin e konstatimit në përputhje me udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme" (trajtuar tek hartimi pasqyrave financiare PASH)

Vlerat e të ardhurave

Të ardhurat e papërdorura janë pasqyruar në kontabilitet në veprimet e mbylljes së çdo viti ushtrimor.

• **Pagesat/ shpenzimet**

Për marrjen e angazhimeve buxhetore është respektuar sistemi i nënshkrimit të dyfishtë nga N.Autorizues dhe N.Zbatues.

Për kryerjen e pagesave për blerje mallra e shërbime konstatohet se është respektuar afati 30 ditor në përputhje me udhëzimin statndard të zbatimit të buxhetit.

Gjetje nga auditimi Nr.3: Për pagesat e avokatëve të thirrur kryesisht në katër raste (U.Shp.nr.104 dt.10.7.2020 me vlerë 33 000 lek, U.Shp.nr.114 dt.16.7.2020 me vlerë 29500 lekë , U.Shp.nr.235 dt.15.12.2020 me vlerë 3600 lekë, U.Shp.nr.276 dt.29.12.2020 me vlerë 27000 lekë) nuk është respektuar masa e shpërblimeve e përcaktuar në urdhërin e përbashkët nr.1284/3 datë 16.03.2005 "Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike" të M.Drejtësisë dhe Kr.Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Për të njëjtin përfaqësim në mbrojtje si; "seancë paraprake" në disa raste masa e pagesës avokatit caktohet 2500 lekë në disa raste të tjera 3000 lekë dhe në disa raste të tjera 6000 lekë ; "caktim masë sigurimi" në disa raste caktohet 2500 lekë në disa të tjerë 3000 lekë).

Rekomandimi Nr.3: Nëpunësi autorizues duhet të marrë masa për tu siguruar përpara kryerjes së pagesës se masa e shpërblimit të avokatëve të thirrur kryesisht është caktuar referuar urdhërit të

Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr.1284/3 datë 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike“ dhe për të njëjtin objekt padie të aplikohet e njëjta masë shpërblimi.

U audituan pagesat për kryerjen e shpenzimeve për ekspertë dhe psikologë dhe rezultojn se ato janë kryer në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Nga auditimi i shpenzimeve postare rezultojn se ato janë të shoqëruara me regjistrin potar I cili është i rakorduar me regjistrat e gjykatës. Njëkohësisht shpenzimet e kryera për energji dhe ujë paguhet mbi bazën e matjes dhe faturave të lëshuara nga operatorët ekonomikë .

• **Menaxhimi i aktiveve**

U auditua menaxhimi i aktiveve për periudhën 2017-2020. Nga auditimi i blerjeve, marrjes në dorëzim të tyre, qarkullimit, dhe inventarizimit të aktiveve konstatohet se:

Aktivet/Asetet janë të regjistruara në emër të gjykatës mbi bazën e dokumentacionit vertetues dhe justifikues.

Aktivet e blera janë marrë në dorëzim me komision të ngritur me urdhër të brendshëm të Nëpunësit Autorizues dhe janë bërë hyrje e marrë në përgjegjësi nga magazinieri mbi bazën e flet hyrjeve të prera e të regjistruara në kontabilitet.

Aktivet e marra pa pagesë janë bërë hyrje (*F.Hyrja nr.26 dt.30/12/2019 për transferim kapital nga KLGJ i Autoveturës Volkswagen Pasat me vlerë 1943000 lekë*) dhe janë pasqyruar tek regjistri i aktiveve të gjykatës.

U auditua ndryshimi i gjendjes së aktiveve (*shtesa dhe pakësime*) dhe konstatohet se shtesat e aktiveve kanë ardhur nga blerjet, dhe transfertat pa pagesë të aktiveve ndërsa pakësime të aktiveve nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe tjetërsimet pa pagesë.

Gjykata ka transferuar/tjetërsuar pa pagesë mbi bazën e marrvshjes përbashkët nr.157 dt.13.10.2020 të gjykatës dhe nr.3192 dt.13.10.2020 të bashkisë Skrapar dhe miratimit të KLGJ me vendimin nr. 72 datë 20.02.2020 Mobilje dhe paisje zyre me flet daljen nr.67 datë 15/10/2020 me vlerë 765500 lekë.

Daljet e aktiveve nga magazina janë kryer mbi bazën e urdhër dorzimit të lëshuar nga kancelari.

› **Inventarizimi i aktiveve**

U audituan procedurat për kryerjen e inventarizimeve të përgjithshme për periudhën 2017-2020. Nga auditimi rezultojn se inventarizimi i përgjithshëm i aktiveve është kryer në përputhje ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhim financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NJSP“ i ndryshuar, pikës 73 dhe 74 e në vijim. Për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm të aktiveve janë ngritur me urdhër të brendshëm të N.Autorizues komisionet e inventarizimit (*për vitin 2017 urdhër i brendshëm nr.146 datë 11.12.2017, për vitin 2018 urdhër i brendshëm nr.156 datë 19.12.2018, për vitin 2019 urdhër i brendshëm nr.104 datë 11.12.2019 dhe për vitin 2020 urdhër i brendshëm nr.95 datë 18.12.2020*).

U audituan procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve dhe rezultojn se procedura e ndjekur është në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhim financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NJSP“, i ndryshuar.

Për cdo rast është marrë miratimi përkatës në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP", i ndryshuar.

Nga ana e Nëpunësit Zbatues është hartuar dhe përditësuar regjistri i përgjithshëm i aktiveve Në përfundim të procedurës së inventarizimit nga komisioni është hartuar relacioni për Nëpunësin Autorizues.

Nga kryerja e inventrizimeve nuk ka patur mungesa dhe tepërica të aktiveve. Rezultati i inventarizimeve është miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur për çdo vit dhe është bazuar në normat e amortizimit të përcaktuara në udhëzimit nr.8 datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme"

› **Detyrimet e papaguara**

Nga auditimi i llogarive kontabël për periudhën 2017-2020 konstatohet se gjykata nuk ka detyrime të papaguara përveç detyrimeve të muajit dhjetor të cdo fund viti të cilat janë paguar në fillim ose gjatë vitit pasardhës.

Detyrimet e papaguara janë pasqyruar në Pasqyrat financiare respektive të çdo viti ushtrimor të mbyllur në pasqyrën e Pozicionit Financiar posti i llogarive të pagueshme (Kl.4).

Llogaritë e detyrimeve kanë analizen përkatëse dhe janë pasqyruar në shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare. (*Shih pasqyrën e pasiveve/detyrimeve*)

2. Hartimi i Pasqyrave Financiare

Auditimi i pasqyrave financiare për periudhën e audituar u përqëndrua në treguesit kryesor të tyre dhe në :

- Vlerësimin se raportet financiare janë të mbështetura në të dhënat e llogarisë
- Vlerësimin e zbatimit të parimeve të përgjithshme për përgatitjen llogarive vjetore.
- Vlerësimin e procedurave të mbylljes së llogarive
- Respektimi i formatit standart të miratuar
- Respektimit të afateve ligjore të përgatitjes e dorëzimit të bilanceve vjetore.
- Pasqyrat shoqësuese dhe të dhënat e tyre.
- Relacionet shpjeguese, etj.
- Respektimi i parimit të vijimësisë (*përputhja e vlerave të posteve / llogarive në çelje të vitit të ri ushtrimor me vlerat në mbyllje të vitit të mëparshëm ushtrimor*)
- Miratimi i pasqyrave financiare

Hartimi i pasqyrave financiare është kryer sipas kërkesave të SKK, të Ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, ligjit nr 9936 datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e shqipërisë" i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012, ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016 dhe ligjit 10296 datë 08/07/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar.

Raportet financiare janë mbështetur në të dhënat e librave të llogarisë. Nga krahasimi i gjendjeve të llogarive në fund të vitit me ato në pasqyrat financiare rezulton se ato janë të barabarta.

Pasqyrat financiare kanë respektuar parimet e përgjithshme të përgatitjes së tyre

Pasqyrat financiare kanë shkresat përcjellëse për depozitimin në degën e thesarit dhe ZABGJ/KLGJ dhe janë dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve sipas programit të cilët janë të rakorduara me degën e thesarit.

Vlerat e posteve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar janë të barabarta me vlerat e posteve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të printuar nga SIFQ e cila është nënshkruar dhe vulosur nga nëpunësi thesarit. Vlerat e posteve/llogarive në çelje të vitit ushtrimor janë të barabarta me vlerat në mbyllje të vitit ushtrimor paraardhës në zbatim të SKK dhe parimit të vijimësisë në vlerësimin e AAGJ.

1.1.Auditimii pasqyrave të pozicionit financiar

a)Aktivet Afatshkurtra

Për periudhën e audituar aktivet afatshkurtra në mbyllje të vitit ushtrimor përkatës paraqiten me gjendjet si vijon:

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Ushtrimi Mbyllur 2020	Ushtrimi Mbyllur 2019	Ushtrimi Mbyllur 2018	Ushtrimi Mbyllur 2017
I	Aktivet Afatshkurtra	8,533,662	7,051,559	9,560,622	7,338,858
	1.Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	3,258,996	2,275,502	5,475,251	2,717,988
531	Mjete monetare ne Arke	0	0	0	0
520	Disponibilitete ne thesar	587,496	1,454,502	574,251	1,139,988
532	Vlera te tjera	2,671,500	821,000	4,901,000	1,578,000
	2.Gjendje Inventari qarkullues	1,743,459	1,334,305	1,236,249	1,270,623
31	Materiale	616,039	395,645	297,589	378,341
32	Inventar i imet	1,127,420	938,660	938,660	892,282
	3. Llogari te Arketueshme	3,531,207	3,441,752	2,849,122	3,350,247
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3,531,207	3,441,752	2,849,122	3,350,247
	4. Te tjera aktive afatshkurtra	0	0	0	0

Logaria 520 paraqit gjendjen e mjeteve monetare në 31/12 dhe përfaqëson mjetet monetare nga arkëtimi i tarifës së shërbimit gjyqësor e cila i derdhet buxhetit në janar të vitit pasardhës, garancitë e punimeve dhe garancitë pasurore. Këto vlera përputhen me aktrakordimin e mbajtur me degën e thesarit dhe janë analitike..

Llogaria 532 paraqet vlerën e pullave të taksës gjendje në 31/12. Kjo llogari për cdo vit ka kartelën e saj analitike dhe gjendja e saj është e rakorduar me procesverbalin e mbajtur në fund të cdo viti ushtrimor edhe me degën e tatim taksave Berat.

Llogaritë 31 dhe 32 paraqesin gjendjen e materialeve në magazinë. Këto llogari kanë inventarin e tyre analitik.

Llogaria 4342 paraqet detyrimin që ka buxheti i shtetit për pagat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre ndaj sigurimeve shoqërore ,shëndetsore etj të muajit dhjetor të cilat paguhen në muajin janar të vitit pasardhës.Vlera e kësaj llogaria është e barabartë me vlerat e listpagesës së kontabilizuar të muajit dhjetor të viti ushtrimor.

b)Aktivet Afatgjata

Aktivet afatgjata për periudhën e audituar në mbyllje të vitit paraqiten si vijon:

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Ushtrimi Mbyllur 2020	Ushtrimi Mbyllur 2019	Ushtrimi Mbyllur 2018	Ushtrimi Mbyllur 2017
II	Aktivet Afatgjata	35,455,142	39,970,963	39,833,679	40,056,662
	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0	0
	2.Aktive Afatgjata materiale	35,455,142	39,970,963	39,833,679	40,056.662
212	Ndertime	27,743,425	29,203,605	30,740,637	43,744,822
214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	948,345	817,335	547,161	860.400
215	Mjete transporti	72,480	2,033,600	113,250	2025600
218	Inventar ekonomik	6,690,891	7,916,422	8,432,630	21,481,170
219	Amortizimi I Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara(-)				-28,055,330
	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
	4.Investime	0	0	0	0

Llogaria 212 paraqet vlerën e dy godinave gjykatës(*godina e gjykatës Berat dhe godina e ish gjykatës Skrapar*) me kosto historike për vitin 2017 dhe me vlerë neto për vitin 2018 e në vijim

Llogaria 214 paraqet vlerën e instalimeve teknike si kondicionerë, paisjeve si sistemi kamerave, fonisë etj me kosto historike për vitin 2017 dhe në vlerën neto nga viti 2018 e në vijim .

Llogaria 215 paraqet vlerën e mjeteve të transportit(*dy autovetura dhe një motoçikletë*) me kosto historike për vitin 2017 dhe në vlerën neto nga viti 2018 e në vijim .

Llogaria 218 paraqet gjendjen në vlerë të zërave “Mobilje Zyre “, ”Paisje informative”, Fotokopje, Printera, Server, etj me kosto historike për vitin 2017 dhe në vlerën neto nga viti 2018 e në vijim .

Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën neto në përputhje me udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018“*Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme*“ nga viti 2018 e në vijim, ndërsa në vitin 2017 paraqiten me vlerën historike dhe amortizimi paraqitet si zë më vete.

c)Pasivet(Detyrimet)dhe Fondet Neto

Pasivet për periudhën e audituar paraqiten si vijon:

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Nr. Llog	EMERTIMI I LLOGARIVE	Ushtrimi	Ushtrimi	Ushtrimi	Ushtrimi
		Mbyllur 2020	Mbyllur 2019	Mbyllur 2018	Mbyllur 2017
	I.Pasivet Afatshkurtra	4,118,703	4,896,254	3,423,373	6,068,235
	1. Llogari te Pagushme	4,118,703	4,896,254	3,423,373	6,068,235
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	20,000	16,938	210,835	500,620
42	Detyrime ndaj personelit	2,435,394	2,392,204	1,827,793	1,964,137
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	400,223	382,840	203,584	226,501
435	Sigurime Shoqerore	489,779	485,739	495,883	535,779
436	Sigurime Shendetsore	107,360	104,538	78,200	84,301
437.438	Organizma te tjere shteterore	78,451	58,968	31,927	38,909
464	Det.per tu paguar per bl. letrave me vlere	0	0	0	1,578,000
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	120,000	1,155,962	574,251	1,139,988
467	Kreditore te ndryshem	0	525	900	0
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	467,496	298,540	0	0
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0	0	0
	II.Pasivet Afatgjata	0	0	0	0
	FONDET NETO PERBEHEN NGA	39,870,101	42,126,268	45,970,928	41,327,285
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/ Deficiti I akumuluar	39,397,265	42,062,587	46,005,302	41,327,286
12	Rezultatet e mbartura	63,682	34,374	0	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	409,154	29,308	-34,374	0

Detyrimet janë të pasqyruara me vlerat e tyre

Llogaria 401-408 paraqesin detyrimet e lindura ndaj operatorëve ekonomikë në muajin dhjetor të vitit ushtrimor të mbyllur por të palikujduara e që janë shlyer në vitin ushtrimor pasardhës.

Kjo llogari është e shoqëruar me listen e operatorve ekonomikë dhe vlerat përkatëse (*Inventarin analitik*).

Llogaria 42 paraqet detyrimet ngaj punonjësve për pagat e muajit Dhjetor që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës. Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën neto të pagave sipas kontabilizimit të listpagesës së muajit dhjetor.

Llogaritë 431,435,436,438 paraqesin përkatësisht detyrimin për tatimin mbi pagat, për sigurimet shoqërore, për sigurimet shëndetsore, për sigurimin suplementar që rrjedhin nga pagat e muajit dhjetor. Vlera e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat sipas kontabilizimit të listpagesës së muajit dhjetor.

Shuma e llogarive të pagueshme të pasiveve afatshkurtëra janë të barabarta me shumën e llogarisë 4342 të paraqitur në aktiv të bilancit.

Llogaria 464 praqet vlerën e pullave të taksës gjendje në 31/12/2017 ndërsa në vitet e tjera paraqitet 0(zero) për shkak të ndryshimit të mënyrës së kontabilizimit sipas udhëzimit nr 8 datë 9.3.2018.

Llogaria 466 praqet vlerën e mjeteve në ruajtje në 31/12 të çdo viti dhe ka inventarin analitik.

Llogaria 4341 praqet vlerën tarifës (90%) që i takon buxhetit të shtetit por që derdhet në buxhet në vitin pasardhës.

Në pasiv paraqitet Fondeve Neto të cilat përbëhen nga:

Llogaria 101 praqet vlerën e fondit të akumuluar/deficitit të akumuluar /fondet Neto.

Llogaria 85 (*rezultati i ushtrimit*) paraqitet me gjendje dhe është e barabartë vlerën e ndryshimit të gjendjeve të llogarive të kl.3(*Inventari qarkullues*)

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Rezultatet e viteve ushtrimor të mbyllur nga 2018 nuk janë transferuar në vitet pasardhës tek rezultatet e mbartura por është transferuar tek llogaria 85 “rezultatit i vitit ushtrimor” jo në përputhje me udhëzimin nr.8 datë 09/03/2018“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme“. Në këtë rast vlerësojmë se nuk duhet trajtuar si gjetje por N.Zbatues duhet të korrigjimet e nevojshme dhe ti pasqyrojë ato në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021.

1.2.Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve(Performancës Financiare)

Për periudhën e audituar të dhënat e të ardhurave dhe shpenzimeve (performancës financiare) paraqiten sipas tabelës në vijim.

Nr. llog.	Emertimi	Ushtrimi i Mbyllur 2020	Ushtrimi i Mbyllur 2019	Ushtrimi i Mbyllur 2018	Ushtrimi i Mbyllur 2017
b	c	1	2	3	4
A	TE ARDHURAT	50,538,341	52,634,185	43,422,152	43,562,986
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	0	198.000	250.000	270.060
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	0	198.000	250.000	270.060
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	0			
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale	0	198.000	250.000	270.060
72	V.GRANTE KORENTE	50,538,341	52,436,185	43,172,152	43,292,926
720	1.Grant korent I Brendshem	50,538,341	52,436,185	43,172,152	43,292,926
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	47.007,134	48.994,433	40,323,030	39,942,679
7206	Financim I pritshe nga buxheti	3,531,207	3,441,752	2,849,122	3,350,247
B	SHPENZIMET	50,129,187	52,536,129	43,456,526	43,614,654
600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	36,226,480	37,773,322	29,163,390	29,132,778
6001	Paga, personel I perhershem	36,226,480	37,411,863	29,163,390	29,132,778
601	ILKONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	4,138,583	4,595,913	4,412,122	4,377,570
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	3,522,471	3,948,112	3,915,308	3,882,238
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	616,112	647,801	496,814	495,332
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	10,060,278	10,100,950	9,801,640	10,002,638
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,119,085	808318	816,919	1,574,158
6021	Materiale dhe sherbime speciale	229,460	32256	95,240	78,764
6022	Sherbime nga te trete	5,849,847	5,985,532	5,637,319	5,353,823
6023	Shpenzime transporti	730,147	676,364	668,247	641,651
6024	Shpenzime udhetimi	127,780	127,120	249,800	346,010
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	142,896	341080	226,470	534,242
6029	Shpenzime te tjera operative	1,861,063	2,130,280	2,107,645	1,473,990
	V.TRANSFERIME KORENTE	113,000	164,000	45,000	50,000
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	113,000	164,000	45,000	50,000
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	113,000	164,000	45,000	50,000
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0	0	0
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit	0	0	0	0
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-409,154	-98,056	34,374	51,661
	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	409,154	98,056	-34,374	

U audituan të dhënat e pasqyrave të performancës financiare nga ku rezulton se :

Në pikën **A.TË ARDHURAT** janë pasqyruar të vlerat përkatëse të të ardhurave të përdorura (*neto*) gjatë vitit ushtrimor e që përbëhen nga granti i buxhetit të shtetit dhe të ardhurat në masën 10% që përfiton gjykata nga vjelja e tarifës së shërbimit gjyqësor.

Të ardhurat e përdorura të vitit ushtrimor janë pasqyruar drejt në llogaritë/postet përkatëse të gjitha të ardhurat. Vlerat e tyre janë të barabarta me fondet neto të pasqyruara në regjistrat kontabël.

Në pikën **B.SHPENZIMET** janë pasqyruar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, sigurime shëndetsore, shpenzimet operative të blerjes së mallrave e shërbimeve, transferta tek individët.

Shpenzimet e vitit ushtrimor janë pasqyruar drejt sipas klasifikimit ekonomik të llogarive kontabël.

Shpenzimet operative janë të detajuara sipas zërave dhe nënzërave të dhe pasqyrojnë drejt dhe në mënyrë të saktë shpenzimet e kryera nga gjykata.

Njëkohësisht vlerat e pasqyruara të shpenzimeve janë në përputhje me planifikimin e bërë në fillim të vitit dhe ndryshimet përkatëse të ndodhur gjatë vitit.

Për regjistrimet e shpenzimeve është respektuar parimi i konstatimit dhe si rrjedhojë janë pasqyruar edhe shpenzimet e papaguara të muajit dhjetor.

Rezultati i ushtrimit tek pasqyra e pozicionit financiar është e barabartë me tepëricën e vitit ushtrimor të pasqyrës së pozicionit financiar.

U auditua pasqyra e fluksit të parave (Cash flow) në të cilën vlerat janë pasqyruar drejt dhe tepërica e likuiditeteve është e barabartë me gjendjen e mjeteve monetare të pasqyrës së pozicionit financiar.

Në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto janë pasqyruar postet me vlerat përkatëse që përbëjnë fondet neto dhe vlera e tyre përputhet me vlerën e tyre në pasqyrën e pozicionit financiar

Në pasqyrat e gjendjes dhe ndryshimit të AAGJ me kosto historike dhe vlerë neto janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në shtimin dhe pakësimin e tyre dhe rakordojnë me pasqyrën e pozicionit financiar.

Në pasqyrën e investimeve dhe burimet e financimit të tyre janë paraqitur shpenzimet për investimet e realizuara dhe burimet e financimit si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta njëkohësisht edhe dhurimet në natyrë

Pasqyrat financiare janë shoqëruar me relacionin shpjegues të posteve dhe vlerave të tyre sipas formatit të miratuar.

Njëkohësisht pasqyrat financiar shoqërohen me pasqyrën statistikore të nr.punonjësve të detajuar dhe fondit të pagave e sigurimeve shoqërore shëndetsore.

Nga vlerësimi nëpërmjet pyetorit në sistemin /fushën e llogarisë dhe përfundimeve të auditimit për këtë sistem vlerësohet **me rrisht të mesëm**

Opinion i përgjithshëm për sistemin: Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e raportimit financiar dhe kontabilitetit vlerësohet pjesërisht efektiv.

4.8 Të ndryshme të dala gjatë angazhimit të auditimit

Gjatë auditimit nuk u konstatuan problematika të tjera të paparashikuara në programin e auditimit.

Rekomandimet sipas sistemeve të audituara:

I. Sistemi i qeverisjes dhe administrimit

Rekomandimi Nr.1: Për garantimin e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë. Të shikohet mundësia për mbylljen me vetrat/material duroalumin/plastik+xham, hyrjeve të koridoreve të katit të parë dhe të dytë të godinës, për të mos lejuar hyrjen e personave që nuk kanë akses hyrje në ambientet ku janë vendosur zyrat e gjyqtareve dhe punonjësve të administratës. Në hyrjen kryesore të instalohet sistemi elektronik me akses kontrolli me kartë që mundeson hyrjen e personave që kanë akses hyrje dhe për monitorimin e hyrje-daljeve të personelit.

Niveli i prioritetit: I mesëm

Afati i zbatimit: Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

V. Sistemi i të ardhurave nga tarifat gjyqësore

Rekomandimi Nr.2: Menaxherët e gjykatës të rishikojnë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke hartuar dhe miratuar një procedurë të qartë (*gjurmën e auditit*) ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka lidhje me përlllogaritjen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore, si dhe mënyren e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi.

Niveli i prioritetit: I mesëm

Afati i zbatimit: Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

VII. Sistemi i raportimit financiar dhe kontabilitetit

Rekomandimi Nr.3: Nëpunësi autorizues duhet të marrë masa për të siguruar përpara kryerjes së pagesës së masa e shpërblimit të avokatëve të thirrur kryesisht është caktuar referuar urdhërit të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr.1284/3 datë 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike“ dhe për të njëjtin objekt padie të aplikohet e njëjta masë shpërblimi.

Niveli i prioritetit: I mesëm

Afati i zbatimit: Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

Raporti përfundimtar hartohet në 3 (tre) kopje, nga të cilat, një kopje administrohet nga DAB-ja, një kopje qëndron në protokoll dhe një kopje i dërgohet gjykatës.

Plani i veprimit i konfirmuar nga ana juaj të dërgohet në DAB pranë KLGJ-së jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së raportit përfundimtar.

Grupi i Auditimit

Agim Koçi

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj

Aneksi 1

PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

PËR GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

Nr	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1	Për garantimin e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë. Të shikohet mundësia për mbylljen me vetrat/material duroalumin/plastik+xham, hyrjet e koridoreve të katit të pare dhe te dyte te godines, per te mos lejuar hyrjen e personave qe nuk kane akses hyrje ne ambientet ku jane vendosur zyrat e gjyqtareve dhe punonjësve te administrates. Në hyrjen kryesore te instalohet sistemi elektronik me akses kontrolli me kartë qe mundeson hyrjen e personave qe kane akses hyrje dhe per monitorimin e hyrje-daljeve të personelit.	I mesëm
2	Menaxherët e gjykatës të rishikojnë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke hartuar dhe miratuar një procedurë të qartë (<i>gjurmën e auditit</i>) ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka lidhje me përlogarifjen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore, si dhe mënyren e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi.	I mesëm
3	Nëpunësi autorizues duhet të marrë masa për tu siguruar përpara kryerjes së pagesës se masa e shpërblimit të avokatëve të thirrur kryesisht është caktuar referuar urdhërit të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr.1284/3 datë 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike” dhe për të njëjtin objekt padie të aplikohet e njëjta masë shpërblimi.	I mesëm

Grupi i Auditimit

Agim Koçi

Aristotel Telhaj

Marijana Sulshabanaj

Formati Standard 10:
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

PLAN VEPRIMI
(I propozuar nga grupi i auditit)

Numri i Reko m.	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	Për garantimin e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në gjykatë. Të shikohet mundësia për mbylljen me vetrat/material duroalumini/plastik+xham, hyrjet e koridoreve të katit të parë dhe te dyte te godines, per te mos lejuar hyrjen e personave qe nuk kane akses hyrje ne ambientet ku jane vendosur zyrat e gjyqtareve dhe punonjësve te administrates. Në hyrjen kryesore te instalohet sistemi elektronik me akses kontrolli me kartë qe mundeson hyrjen e personave qe kane akses hyrje dhe per monitorimin e hyrje-daljeve të personelit.	I mesëm	Fq.13		Menjëherë	
2	Menaxherët e gjykatës të rishikojnë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke hartuar dhe miratuar një procedurë të qartë (<i>gjurmën e auditit</i>) ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka lidhje me përlllogarijen dhe arkëtimin e tarifës gjyqësore, si dhe mënyrën e mbikqyrjes dhe monitorimit të këtij procesi.	I mesëm	Fq.20 dhe 21		Menjëherë	
3	Nëpunësi autorizues duhet të marrë masa për tu siguruar përpara kryerjes së pagesës se masa e shpërblimit të avokatëve të thirrur kryesisht është caktuar referuar urdhrërit të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr.1284/3 datë 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënieën e ndihmës juridike“ dhe për të njëjtin objekt padie të aplikohet e njëjta masë shpërblimi.	I mesëm	Fq.31 dhe 32		Menjëherë	

Grupi i Auditimit

Agim Koci

Aristotel Telhaj

Marjana Sulshabanaj

Handwritten signatures in blue ink, corresponding to the names listed above. The signatures are stylized and overlapping.